


ΒΚΛ


Η 31. 36'

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ  
ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ



026000339818



A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long, sweeping tail that extends to the right.

ETËHEM HAXHIADEMI

# ULISI

Tragedi me pesë akte

BERLIN, 1924

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ  
ΕΥΑΓΓΕΛΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΙΑ  
ΛΑΥΡΙΩΤΟΥ  
ΑΥΓΟΥ ΑΡΙΘ.

TIRANË  
BOTUAR PREJ SHTYP. KRISTO P. LUARASI  
1931



Αριθ. ΕΠ. 141491

ΕΤΕΗΕΜ ΗΑΧΗΑΔΕΜΗ

# ULISI



Tragedi më pesë akte




BERLIN, 1924

*Βιβλίο κ. Τυ.  
Βολφ. Κορίθης  
Peri Nektar e Nektara  
Nektar Kakhade  
Athens. 25. VI. 1937*



TIRANË  
BOTUAR PREJ SHYTP. KRISTO P. LUARAS  
1931




# VETËT:

ULISI  
PENELOPEJA  
TELEMAKU  
TELEGONI

Scena është n' lthakë, në një breg deti.



Parathanëje



*Si prishën Trojën, qytetin e pasun të Priamit trimat e Greqis — për të cilin patën derdhë gjak dhe vjet me rrjeshtë dhe patën ranë të vdek nga të dy anët atà mã trimat — i hypën anijavet, dhe, si fryni nji erë e mirë, udhëtuën me gas me shpresë se do të shihshin për së shpejti atdhën, ku gjithë se cillin e priste gruaja e fëmija e vet me mallë të math. Por prej zemërlmit të perëndijvet vetëm pak nga atà sosën fatbardhë n' atdhë dhe të t'jerët brodhën mjaft kohë nëpër tokë e dël deri sá gjetën vendet e 'tyne.*

*At, qì kishte fituë mã tepër mënin e perëndijvet dhe qì që dënuë të shetiste kot e kot shumë vise të botës, që trimi i Ithakës Ullsi, sepse ky kishte verbuë nji nga ciklopët, Polifemin, të birin e Neptunit dhe se shokët e 'tij kishin therë lopët e Diellit, Ullsi mbas shumë vltesh, me ndihmën e Minervës, sosti prap n' Ithakë dhe mbretoi ashtu si mã përpara. Mbas ca kohe ai shkoi në Thesproti për me i sjellë fli Minervës në nji tempël t' atjeshëm; kùr këiheu prapë n' Ithakë e shoqja, Penelopeja, me të birin, Telemakun, i kishin dalë përpara në buzë të detit, ku ndodhesh dhe kasollja e bartut besnik, Eumeut, për me e pritë, aty ku asht scena e tragedis s' ime.*

*Ullsi aty u takuë me Telegontin, djalin e vet qì e kishte me Circein i cili kishte ikë prej vendit s' amës për me kërkue t' anë. Këta, mbassi s' u njohtën dhe mbassi Ullsi e thërriti të birin kusár deti, u kapën*



*dhe prandaj Telegoni e vret t' anë mbëshehtazi tyke e qelluë me shigjetën qi i dhuroi Penelopeja. Sipër kësaj shigjete Telegoni kishte ngjitë një halë të madhe peshku me helm dhe ja pat falë e ama, CIRCJA, për t' u mprojtë kundër anm qvet.*

*Kjo asht prà landa e tragedis s' ime dhe besoj se vepra kà me u pëlqyë kënduësëvet të ndershëm, mbasst asht e para tragedi e shkruëme në gjuhën shqipe dhe landa e marrme nga Mithologija greke, qi ka qenë një thesár i math për poetët tragikë të botës së qytetnuëme.*

Berlin, 8 Mars 1924



# AKT'I PARË

---

## SCEN'E PARË

### ULISI

Me gas e shoh përsri lthakën t'ime,  
Kto vise plot me shqembe t' that', pa bime,  
O bij'e Jovit, perëndesh' qiellore.  
Sikur i lash'kto vende pak pjellore,  
Kúr shkova un në Troj', në luft'n e gjatë,  
Nj'ashtu i gjenj: të shveshme dhe të thatë.  
Nuk ka ndërruë as gjâ, veç koha shkon  
Dhe jet' e njerzvet bashk' me'tê kalon....  
Por juve, o hyjni, ju qoft' lavdi  
Qi muë n'atdhë më sullët përsëri.  
Atdhé! Sá fjal'e ambël asht, në veshë  
Sá mir'ndëgjohet! Ah, në Troj'kúr qeshë  
Shum'her' të merite malli për shtëpi,  
Për vend'n e lindjes dhe për shoqëni  
E mallëngjehesh tepër. Mosh'e artë!  
Për njerzit ti je koha mâ e zjarrtë!  
Ti je pranver'e jetës s'on', por ah,  
Mue pak nga pak po m'len tash dor' e krah  
Dhe hyj' nga dal në moshën pleqënore!  
Kúr isha djal i ri sá jet' gazmore  
Kam shkumun!... Ah, më vjen si tash ndër mend  
Për gjah kúr dilja n'diinën fjesht gazmend  
Me shok't e mij! Ndër valle mallëngjyëse  
Sá her'na shkriheshim! Ah, koh'gënjyëse!  
Atà qi pata shok'un në rini,  
Më dulën muë anmiq për pleqëni.  
Penelopën kërkoshin me m'a rrmjë,  
Me gjak dhe Telemakun me m'a lyë





Dhe gjan'e pasjen t'm'a gremisshin krejt.  
Prandaj muër funt miqsi e jon'shum'shepejt  
Tyke i shuë të gjith'me harkun t'im  
Kusarët e pabes'dhe pa gjykim.  
Dhe ty, Minerv', moj perëndesh', sá t'rroj  
Me gjak fulijsh altarin do t'a mbloj,  
Se ti dëshroje rrojtjën t'ime. Prá  
Dhe ti ke m'u nderumun shpesh ke na  
Edhë ke vendësit Ithakijanë  
E an'e mb'an'n'ujdhesën t'on'të tanë.  
Edhë sikundër qi, si nga Cikonët,  
Si nga Sirenat dhe nga Lestrigonët,  
Si nga Ciklopët dhe nga Lotofagët  
Më ruëjte dhe më prune prap n'Ithakët  
Tyke m'shpëtuë nga Karibda damtare,  
Nj'ashtu më jep, moj perëndesh' bujare,  
Dhe tash një shpres'të gjall'për koh'n e ardhshme  
Qi t'rroj fatbardh'me fmijn'e gruën e dashme  
Dhe gjindja urdhnave të mij t'u sh'rohet  
E zan'i paqës rishtas të ndëgjohet.

## SCEN'E DYTË

PENELOPEJA, ULISI.

PENELOPEJA

Kam koh'qi rreth e rrotull po shetis  
Qi të kërkonja ty, i shtrenjt Ullis.  
Eh, ç'ban këtë nashti a nuk më thuë?

ULISI

O bij'e mbret Ikarios dhe gruë  
Besnike, mâ e rand'në t'gjith këtë vend,  
Me mall i kqyr kto vise plot gazmend;  
Se mâ në funt, si kaq rreziqe shkuën,  
Hyjnit përsri n'atdhën e shtrenjt'më pruën.



Ja ndjefa t'shoh prá rishtazi ktà brigje,  
Kta o male dhe kto fusha e ktà shtigje  
Për t'cilat mjaft muë malli më përvloi;  
Dhe për kët' shkak nashti po duë t'vështroj  
Me gas të math kta vende pa njeri,  
Sá ty, moj mbretënesh', të dhash' mërzi.  
Por ty të them gëzohu, gruë, se pé  
Qi të sundoj' Ulisi prap n'atdhé  
Madhnisht me scepërë t'famshme — si rreno  
Me mjeshtëri të veçant' të pasmen Trojë  
Edhë si shoi dashnorët t'uëj t'mallkuë  
Të gjith' — e se prap e Ulisit gruë  
Po quhe, në ujdhesën t'on' mbretneshë  
Me famë. Në ç'do an' të dheut qi qeshë,  
Kúr bridhja kot e kot un pa pushim  
Nga përendijt, ndëgjova lavdin t'im  
Në goj' të ç'do njeriu. Prandaj dhe muë  
S'më duhet t'jetër gjâ, por veç me ju  
Do t'rroj, gjersa t'mos vijn' ndër na kusarët  
E t'mos e ngasin gjan' qi lan' të parët,  
Por ti pse rrin kështú e preme krejt  
Qëkurse erdhe? Fol, m'kallxò prá shpejt.  
Ti mâ përpara muë m'i ke kallxuë  
Bregimet t'uëja; tash a nuk më thuë  
Ç'mendim t'bregos, se ti s'ke qen' kshtu kúrr?

### PENELOPEJA

Ulis i dashun dhe i ndershëm búrr,  
Qi për gjykim hyjnivel i afrohe;  
Sadoqi ti anmiqt të gjith' i shove  
Dhe paqa prap filloi n'lthak' t'mbretnojë,  
Muë prap kjo gjâ as pak nuk më gëzol;  
Se muë më dridhet zemra pa pushuë,  
Kúr sjell ndër mend qi ti i ke verbuë  
Neptunit t'birin, Polifem'n e shkretë,  
Ciklopin mâ të fort' qi munt të ketë.



Dhe frikën un, Ullis, e kam për ty  
Qi ndonj' e keqe mos të vinj' mbi kryë  
Nga zemërim' i 'tij, se perëndi  
Neptuni asht edhë atà kan' mní  
Të madhe shum' ndër zemëra për na.  
Kjo gjâ më ban qi të mendohmi prá,  
Se un prej perëndijvet t'shenjt' frikohem,  
Ullis, shum' tepër dhe prandaj mendohem.

### ULISI

E marr' prá je nashti për kta mendime!  
Frikohe ende ti, mbretnesh' e ime,  
Mâ prej Neptunit, t'cilit mjaft fuli  
I pruna ktu n'lthak' e n'Thesprotí?  
Largoja mendjes frikën prá, moj gruë,  
Se un qi aq rreziqe pa numruë  
I sosa n'funt dhe sosa sot n'shtëpi,  
S'ka mâ rrezik, mbretnesh', për muë përsri,  
Se flí u ban' n'altar të perëndís  
Shtat qingja t'zes qi pishin ende sisë.  
Shikò: un themi t'rrijm' këtù na sot  
Nëpër kto vende t'blerta, mbassi mot  
Të bukur kemi: qielli asht pa ré.

### PENELOPEJA

U bâft' ashtù si ti dëshirën ke,  
Ullis, për kte s'kam me t'u kundrështuë;  
Por vetëm frika nuk më hiqet muë  
Nga zemra, mbassi t'gjith' atà qi shkuën  
Në Troj' prej mbretënvët t'Greqís fituën  
Mënin e Jovit, atit t'perëndijvet,  
Qi rrin n'Olimp në ball të gjith' hyjnivet:  
Kush ra në luftë, kush u mbyt nga deti,  
Dhe vdekjen kush n'atdhë të 'tij e gjeti;  
Mëni e perëndijvet t'gjith' i shoi,  
Sepse edhë Akili kshtu na shkoi  
Nga bota: Apolloni tyk' e vrá  
Me dor' t'Paridit, qi veç donte grá.



### ULISI

Po t'kisha ardhë vetëm un prej Troje,  
Ahere të kishte hije ty t'ligjroje  
Kështu edhe të kishje frik'; por ti  
E din, moj mbretënes', qi rrojn' nashti  
Dhe t'jer' qi prishën Trojën ndër pallate  
Të veta t'lumtun. Kot ti vehtes s'ate  
Ashtu dhe muë më ep mërzi pa punë.

### PENELOPEJA

Ullis, nga fjalët qi po të them un  
Kaq shpejt mos u mërzit, se veç për ty  
Kam frikë, qi të pash' me zi me sy  
Mbas kaq ndërrime stinash. Prá shikò:  
Në qoftse m'don në të vërtet' m'kallxò  
Të drejtën për ç'fardo qi t'pyës nashti.

### ULISI

Eh fol, deh fol; veç mos ndonji marri:

### PENELOPEJA

Dy qind e pesdhit hana nalt mbi qiellin  
Dan' ardh' për qark e njizet her' dhe Prillin  
E suëll pranvera, që kur u mbaruë  
E shkreta luft'; dhe ti e ke kaluë  
Të gjith' kët' koh' të gjat' andëj këndëj  
Tyk' bredh' ndër male dhe nëpër shkëmbenj  
E tyke hjekë shum' rreziqe n'dët  
Sá shokët t'uëj i humbe krej për jetë;  
Por bashk' me nimfen Kalipso ti muë  
Më kë dëftyë qi shum' koh' ke banuë  
Edhë me Circen fjesht magji ke çuë  
Nji jet' të kandshme dhe më ke kallxuë  
Për 'to shum' gjâ, por nuk ke thanë kurr  
Qi lé a jo ndonji fëmi, o búrr  
Në shpell' t'atynve ti kur ike. Prá  
Na thuj t'vërtetën qi t'a dijm' dhe na



Si asht; vértet s'i leu ndonji fëmi  
As Kalipsos as Circes fjesht magji?

ULISI

Nuk asht e para her', moj mbretëneshë,  
Qi m'pyët për nimfen dhe për at' hyjneshë  
Ti muë; prandaj t'i lam' kto fjal' nashti,  
Se s'asht nevoja t'nisen përsëri;  
Por asht mâ mir' qi na të bisedojmë  
Mbi gjá të ra, sa t'vjetrat t'i kujtojmë.

PENELOPEJA

Ah, un e vorfna; kúrr s'm'a ke kallxuë  
T'vértetën e ksaj pyetje ti muë,  
Ulis, dhe un jam lodhun fare kot  
Gjithnji tyke të pyëtun deri sot.

SCEN'E TRETË

ULISI

Çudí kjo gruë: për Circen m'flet gjithnji  
Dhe m'pyet a ka a jo ndonji fëmi,  
Kështù edhë për nimfen Kalipsò;  
Por un s'i them gjâ t'jetër veçse jo,  
Se s'duë t'i flas qi m'rron muë lark atje  
Në shpell' të shenjt të Circes, n'atë dhé,  
Nji djál i dyt', se zemërohet shpejt.  
I dashmi djál!..... Të lash' të vogël krejt ...  
Si lindi foshnja m'vjen muë tash ndër mend:  
Ahere ishte ftohët shum' n'at' vend  
Dhe shpella sipër fjesht me bor' ish mveshë....  
E ti ahere n'gjinj', moj perëndeshë,  
E mbaje foshnjen dhe m'a linje muë  
Në prehën nga nji her' për me provuë  
A qante djali; por ai nuk rrinte  
Ke un dhe donte veç ke ti të flinte.



Kshtu asht kjo bot'! Sá asht njeriu i ri  
S'i ndahet gjinit t'prindvet; s'mund të rrijë  
Pa 'ta; por kúr arrin pastáj në shkallë  
Të djelmënis dhe prindët shpres' të gjallë  
Kan' lidh' ke fmija, gjâ të t'jera ka  
Ndër mend ai pastaj e s'pyët për 'ta.  
Ku shkoi mundim' i juëj, moj nana të shkreta!  
Por un një fjalë t'ambël kúrr s'e gjeta  
T'ja thojë nanës s'ime aq të mirë  
Kúr rronte, Sa i lik jam, pa mëshirë!  
E shkreta prap me shpirtit muë më donte....  
Kúr shkova në luft'n e Trojës ende rronte  
Ahere; ah, e mjera me zi mbahesh  
Nga pak dhe qante, se prej meje ndahesh!  
Nashti si erdha nuk e gjeta gjallë;  
Kish vdek' me koh', se pat për me shumë mallë!  
Ah, nan', ku je nashti, moj nan' e shkretë....  
I vorfni un; të humba krejt për jetë!....  
Por djal' i dyt' sá lark prej meje rron!  
E bukra Circ' e quejti Telegon  
Ahere; ah, do t'rrinja plot haré  
Dhe ke ajò hyjnesh', por për atdhé,  
Për gruën e dashme dhe për Telemakun  
Më mori malli shumë, më ndezi gjakun.  
Por un jam at dy djelmsh nashti; kjo gjâ  
M'gëzòn muë mjaft... por ah, ç'e don, un mâ  
S'e shoh për jetë Telegonin t'im;  
S'e dij a rron a jo; ç'asht ky mjerim,  
O perëndij? O Telegon, o bir,  
Të shohsh t'yt at ti s'ke as pak dëshirë?  
E din ti vall qi at të dashun muë  
Më ke? Jot'am'ty, Circja, t'ka kallxuë?  
O Jupiter m'a sjell t'im bir t'a shoh  
Me sy dhe para se të vdes t'a njoh,  
Se zemra muë m'asht bâ për 'të thërrime!....  
Por s'duë t'a marrí vesht dhe gruj' e Ime,



Se zemërohet mbasandaj. Ah, sot  
Nuk dij se ç'ka ajò, s'e marr vesht dot!  
Dhe kúr e pyës më thot'qi frikësohet  
Fort prej Neptunit dhe prandaj helmohet.  
A mbasse dhe ajò të drejt' munt t'ketë?  
Ah, sá e dhimshme je, moj jet' e shkretë!

### SCEN' E KATËRTE

TELEMAKU, ULISI

TELEMAKU

Ç'po ban, o at, ktu vetëm? Ç'far' mendòn?  
Pse rrin kshtu kryekrrusun? Ç'gjâ t'mungòn?  
Kallxoi t'yt biri qi për ty gjithnji  
T'a banjë vehten fli ka qen' gati  
Dhe qi ç'do gas e helm t'a daj' me ty  
Dëshron. Të lutem shum' për me m'dëflyë  
Ti muë nashti, o at i dashun, ç'ké,  
Se un të shoh qi plot mendime jé.

ULISI

O ti i vetmi gas i jetës s'ime,  
O Telemak, qi me kto bisedime  
Më bane qi nga gazi të vajtoj;  
Afrohu, bir i shtrenjt, qi t'përqafòj,  
Se kúr ndëgjoj kso fjalësh un prej teje,  
Prej gazit gjaku më lëvrin ndër deje.  
Dëgjò, o djal; ktu që mâ par' jot amë,  
E cila shum' t'idhnumun më ka bamë,  
Sepse, sikur e din, ajò ligjròn  
Gjithnji për Polifemin dhe kujtòn  
Qi ka me m'ndjek' Neptun' i detit muë;  
Por, ndonse desha un me ja larguë  
At' frik' asaj dhe s'doja t'i tregohesh  
Se për at' çashtje edhe vet' frikohesh,



Un prap të themi ty qi fjal' të plota  
Ka fol' jot am', o bir, dhe s' qen' të kota  
Çka tha ajò, sepse porsì përrpara  
E shoh qi punët nuk po vejn' të mbara  
Edhè n' lthakë mâ. Për këtë shkak  
Mendohesh un ashtù, o Telemak.

### TELEMAKU

Ti fole pak, por fjalët plot kuptim  
I the, o at, dhe t' gjitha me gjykim;  
Por ti tyke e pa ciklopin t' egër  
Me trup të frikshëm porsì nji koçedër,  
Ç'të duhesh ty, o at, qi t' a verboje  
Dhe syn e math e t' vetëm të ja shpoje?  
S' munt t' ikje ti mbëshehtas prej atij  
Dhe kshtu t' shpëtoje nga çdo fatkeqsí  
Qi munt të gjinte? "

### ULISI

Ah, mor djal, ç'më thuë!  
Por un në shpellët isha i rrethué  
Me shok' t' e, mij dhe s' mundshim të shpëtoshim,  
Si thuë, dhe nga rreziku të largohshim,  
Se Polifemi derën me nji gúr  
E mbylli qi i math që sa nji múr.  
Por ah kushdo, o djal, si un do t' bante,  
Se kúr filloi pastaj qi të m' i hante  
Muë shokët dal nga dal; ahere pashë  
Qi qesh' n' rrezik dhe vet; prandaj i dhashë.  
Mjaft ven' atij, mbassi e donte shumë,  
Dhe si e deja mir', e vuna n' gjumë,  
Ahere ngrihem dhe nji druë hollova;  
I rash' pastaj me t' të dhe syn ja shpova.  
Ç'të banja? Qysh të mprohesh un mâ mirë?  
Por prap un nuk e dinja qi që bir  
Hyjnor ciklopi, aq nji egërsín  
E madhe, sá qi t' a frikoj' njerín,





E prá, sikundër sheh, un nuk kam faj,  
O bir; por duhet qi për mbaskëndaj  
T'mendohmi; qysh të bajm'e qysh t'punojmë  
Qi kët'të pakët jet'me gas t'a shkojmë  
Dhe me ç'mënyr't'largohmi nga marrzit  
E prap lumni t'na sjellin perëndit.

### TELEMAKU

Un them qi n'templin e Minervës t'çojmë  
Ndonji njeri qi t'pyësi dhe t'kuptojmë  
Se ç'far'oraklli na kan'pregatitë  
Banuësit e Olimpiti, perëndit,  
Për fatin e pastajshëm. Ti ç'po thuë?

### ULISI

Shum'bukur fole, djal; kjo gjâ dhe muë  
M'pëlqen; në templin e Minervës t'shkojë  
Ndonjani që nashti dhe t'mos vënojë  
E t'qellet udhës, por më t'shpejt'të vinjë,  
Orakullin e shenjt t'më banj'qi t'dijë,  
Se shpresë t'jetër s'na ka mbatë më  
Përveç se t'pyësim at'hyjnesh'. Hâ prá,  
O bir i dashun, Telemak, vrapò;  
Shko thuj ndonjanit shpejt e mos përtò,  
Sepse orakllit t'sáj i zânj un besë  
Dhe kurdohér prej'saj kam pritë shpresë.  
Për armët e Akilit me Ajacin  
Kúr un u zuna — mbassi i përkasin  
Atij qi prej anmikut e shpëtoi  
Gufom'n e trimit than'të gjith'në Trojë —  
Me ndihmën e Minervës Grekët muë  
M'i dhan'atò ahëre dhe këshfù  
Nga zemërimi u marruë i shkreti  
Ajac'i Salaminës dhe e gjeti  
Dhe vdekjen po nga dor'e vet. Po kshtu  
Dhe për ç'do t'jetër gjâ më ka ndihmuë



Minerva, dhe e presim po prej, saj  
Na fatin t'on', o bir, për paskëtaj.  
Prandaj dhe ti dërgoje sá mâ parë  
Ndonjanin në qytet për me na marrë  
Orakllin e hyjneshës ndihmëtare,  
Se ndryshe, bir, s' po kemi shpres' mâ fare.

### TELEMAKU

Mbi krye sipër; tash po shkoj, o at;  
Por na, a s' do t'i apim ndonj' dhuratë  
Me vehte si gjithmon' atij udhtari —  
Qi do të shkoj' në tempël e do t'marri  
Orakllin, fjal' n e madhe të hyjneshës  
Nga goj' e shërbëtores, priftëneshës —  
A s' do t'i apim prá qi t'a vendosi  
Atë n' altar t'hyjneshës kúr të sosi?  
Kjo asht një dok' e vendit; duhen çuë  
Në tempël dhe durata. Tí ç' më thuë?

### ULISI

Pa fjal', o djal, na duhet t'çojm' dhurata.  
arrova t'themi, por në mend e pata  
Un mâ përpara për me t'than' për 'to.  
Hâ prá, o bir, ç' po pret ti mâ? Hâ shko  
E thuj s'at'am' ç' të duhet qi t'a api;  
Nis dhe njerin dhe thuj sa t'mundi t'vrapi.  
— Ndalò, ndalò dhe pakëz, se dy fjalë  
Harrova pa t'i thanë ty, o djal.  
Gjersá oraklli ne s'na ka lajmuë,  
Këndeje as njanit s'duhet m'u kallxuë  
Qi cillët jemi, se kush din se ç'ngjanë;  
Pastaj dhe vetëm jemi ndër kto anë  
E mbasse na qillòn ndonj' fatkeqsi.  
Prandaj po pé këndeje ndonji njeri  
Qi nuk é njeh mos t'i dëftejsh kush je.



TELEMAKU

Me nj' mendje qenkim për këtë qi thë;  
Këndeje as fare s'duhet me kallxuë.

ULISI

Nj' ashtu; nashti ti mundesh prap me shkuë.

SCEN'E PESTË

ULISI

Minerv', prej teje shpres' edhë këtë herë  
Un pres për me m'ndihmuë, hyjnesh' me vlerë!  
Kujtomë pra nashti, në këtë ças  
Qi po t'thërres; se po m'ndihmove gas  
I math do t'm'a përgdheli zemrën muë.  
Oh, ç'jetë t'ambël kam për me kaluë  
Si frika zemrës ka me iu larguë!  
Un me Penelopén kam për me rruë  
Fatbardh' dhe do t'a kemi pran' gjithnji  
T'im bir e kurr s'e lanj atdhén përsri  
Për me luftuë aq lark, se un në Trojë  
Fitova lavd aq shum' sá nëpër gojë  
Të nipënvat t'Greqís ka për më mbetë  
Dhe emn'i em i famshëm do të jetë.  
Por muë nashti dashnija familjare  
M'sundòn: për atin qi u plak mâ fare  
Dhe asht rrozbitë krejt e ka mbet' shkret  
Dhe për Penelopén, qi tridhet vjet  
Me rradh' për muë e shkreta hoqi mall  
Me Telemakun, djalin t'im qi rrall  
I gjindet shoku, m'duhet muë nashti  
T'kujdesem për të dashunit e mij



Qi t'ken jetes' të mir', se s'ka lumni  
Mâ t'madhe sá e shkumja n'familí,  
Midis të shoqi shoqit mir'. Ah, sá  
I lumtun asht nji at qi ndjef me pá  
Të rritun bijt e bijat dhe t'shikojë  
Shtëpin të mbushme, mbassi t'i martojë  
Atà me nuse dhe me dhandrú plot!  
I lumtun vdes e s'duhet qa me lot,  
Po ndjefi t' shohi dhe fëmijt e fmijs  
Qi t'brohorisin nëpër fush' t'shtëpis  
Atò si foshnjet fjesht gëzim gjithnji  
Stërviten! Prá kjo asht fatbardhësi  
Për nji njeri në mosn' të pleqënis:  
Kur gjindet pran' të birit e të bijs.  
Të shkoj dhe un nashti, se mjaft po kam  
Qi rrij këtú dhe fare vetëm jam.

---

*Fund' i aktit të parë.*

---



# AKT' I DYTË

## SCEN' E PARË

### TELEMAKU

Mbas urdhnit të t' im áti e dërgova  
Nji shërbetór n' qytet dhe e mësova  
Qi t' shkoj' në templin e hyjneshës s' onë,  
Minervës, qi na ka ndihmuë gjithmonë.  
Atje pastaj të pyësi mbas ojtnis  
Se qysh të bajm' për mnin e perëndís,  
Qi atin t' im gjithnji e ka munduë,  
Që kur se Troja krejt u shkatërruë.  
Ai nashti ka sos' n' qytet; n' altár  
Të perëndeshës ka me qen' tyk' marrë  
Fjalín e shenjt', orakullin kujtoj.  
Ah, kúr do t' vinj mâ ktu, se s' po duròj  
Pa marrë vesht fundimin e hyjnis  
Së detit un për fat'n e familís.  
Por prap e quj un veten shum' fatbardhë  
Qi atin në shtëpi e pash' me ardhë,  
Së gjersa që ai në luft' n e shkretë  
Se qysh kam hjek' m' a din muë shpirtli vetë  
Nga disà njerës t' liq ithakijanë.  
Por hark' i trimit tash atà të tanë  
I shoi dhe qetësija do t' mbretnojë  
Kudo e vendi mbretin do t' lavdojë  
Po që qi fjal' të mira të na marri  
Nga goj' e priftëneshës dërgimtari:  
Ligsít e dheut atbot' do t' i kalojmë  
Mën scepitrën e Ulisit mbassi t' rrojmë.  
Sá koh' e bukur ban sot! Ç' qiell të rrimët  
Po kemi! Ndër kto brigje t' kandëshme bimët



E rralla plot me gas po gjelbërojnë  
Dhe lisat fllad të kandshëm na lëshojnë.  
O vende t'bukra për banuësit t'uëj;  
Sá mall të math, kúr qé në vend të huëj,  
Pat ati për t'ju pamun përsëri!  
Te ju kam lujt dhe un në vogëlni  
Me gas, kur Maji mbushte plot gjelbërime  
Livadhet si dhe qipshtet plot më bime!  
Por 'q' atëhere ç'koh' e gjat' ka shkuë  
Qi nëpër ju un mâ nuk kam kaluë!...  
Dëgjoj ca kamb'... kush vjen?... kush do të jetë?...  
Ahà, Penelopeja; t'shoh ç' do t' ketë.

---

## SCEN' E DYTË

---

PENELOPEJA, TELEMAKU

PENELOPEJA

Sá gas të math qi ndjenj kúr t'shoh me sy,  
O bír i dashun dhe i shtrejt! Pa ty  
Mue mos më lançin perëndijt; ti m'rrofsh  
Mâ tepër se Laerti dhe më qofsh  
I lumtun për gjithmon', se kúr yt at  
Në Trojë qe, në luftën aq të gjatë,  
Për ç' do brëngim të paç un ty pjestár,  
Ô Telemak i dashun, djal i mbár.  
Por ah, t'a dijsht ti si kjo zemr' e ime  
Asht mbushun rishtas plot me hidhërime!

TELEMAKU

Moj nan' e dashun, ç' ke ti kshtu? Përsë  
Je kaq e preme sot? Hâ prá m'dëftë,  
Se mbshehtësína s' duhet na të dy  
Të kemi ndërmjet nesh.



PENELOPEJA

Ah, un me ty  
Ç' do gjâ të mbshehët duë t' a bisedoj  
Dhe ç' kam në zemër ty duë t' a kallxoj,  
O bir, ... dëgjò një andër t' keqe shumë,  
Të cilën un dje mbram' e pash' në gjumë,  
Dhe kúr e sjell në mendje trupi m' dridhet.  
Duë t' a kallxoi, por ah muë gjuha m' lidhet  
Nga tmerr' i math qi pash'.

TELEMAKU

Nji andërr pé?  
Ah nan', atynve s' asht për t' u vum' ré;  
Se andrra shumë kam pa un der' nashti,  
Por po të them qi nuk ka dal' as një  
Prej t' gjithave sá pash' un e vërtetë.  
Dhe ti mendón mbi gjâ të kqija vetë,  
Prandaj të vijn të vshtira andrrat natën;  
Por hâ, m' a thuj një her'.

PENELOPEJA

Më paç uratën,  
O bir, qi don s' at' am' me ja larguë  
Idhnit e zemrës dhe me e qetuë.  
Un mbram', porsa paç ran' në gjum' të parë,  
M' u duk sikur më thoshte dërgimtar,  
I Jovit muë, Merkuri, këtò fjalë  
Të frikshme tyk' i thanë me nga dalë:  
„Banuës Olimpi jam, moj mbretëneshë,  
Dhe vijn me t' than' qi në kujdes t' a keshë  
Prej t' birit ti t' yt shoq dhe t' mos e hasi,  
Se jetën do t' ja marri, do t' a vراسي"  
Porsa tha kshtu, u shduk e fluturoi  
Dhe mue tristim' i math ahëre m' qoi.  
Nji andërr kaq të keqe nuk kam pa  
Un kúr edhë mos pafsha t' jetër më.



TELEMAKU

Ti fole fjalë t'idhta shum', moj nanë,  
Por andërr qe ajò dhe s'duhet dhanë  
Verejtje, se ahëre do t'gënjeshin  
Hyjnit dhe fjal'të drejta s'do t'dëfteshin,  
Merkuri po të thoshte me t'vërtetë,  
Se ati mâ nga un do t'humbi jetë;  
Mbassi këtù ku jemi na nashiti  
Un kuvendova plot me ambëlsi  
Me mbretin t'on'e burrin tand të shtrejtë  
Pak mâ përpara. Prá nuk asht e drejtë,  
Moj nan'e dashun, andërra qi pé  
Dhe prap po t'them atynve s'don vuë ré;  
Prandaj ti andrra fare mos besò,  
Se fantazit e gjumit jan'atò.

PENELOPEJA

Ah, Telemak, mendò'nji her'sá muëj  
Ka çuë yt at atje në vend të huëj  
Tyk'ndejt me Circen dhe me Kalipsòn.  
Ai ka ndonj'fëmij' më'lò. S'besòn  
Se munt Ulisi kshtu nga dor'e'tij  
Ke Hadi t'shkojë ndonji her'si fli  
Dhe ne na kputet shtylla e shlëpis  
E ngjyhemì pastaj me petka t'zis?

TELEMAKU

Ç'fëmij'të t'jer'ka átì? Kush ka thanë?

PONELOPEJA

Un them mbas mendjes s'ime.

TELEMAKU

Ah, moj nanë,  
T'kam than'qi ti veç gjâ të kqija ndiell  
Dhe vehtes s'ate breng të math i siell.





Por asht e mundshme qi të kel'fëmijë :  
Yt shoq me t'jera grá dhe t'mos t'a dijë  
Pastaj as ti, as un me ke i ká?  
Jan'gjâ qi bahen kto qi flet ti prá?  
Por gjithsesi ti kij dhe pak durim,  
Se a për humbje asè për shpëtim  
Oraklli, fjal'e shenjt'do t'a dallojë  
Qi shërbëtor'i jon; do t'a kallxojë,  
Si t'vinj' prej templit ku e kemi çuë  
Për fat'n e ardhshëm me na lajmëruë.  
Qetohu prá dhe flinje mendjen fare,  
Se ne na mpron hyjnesha ndihmëtare.

### PONELOPEJA

Më ngjan qi vjen dikush, o Telemak,  
Se po ndëgjoj ca kamb'; ven ré ti pak....  
Po vjen Ulisi; ah, eja mbë nj'anë  
Të rrijm' e të ndëgjojm' se ç'ka me thanë,  
Se ndoshta lutet 'te ndonj' perëndi  
Për ndonji gjâ, të cilën un s'e dij.

### SCEN' E TRËTË

ULISI, PENELOPEJA, TELEMAKU

#### ULISI

S'më gjen' muë shpirti paq' pa ardh' udhtari  
Qi shkoi orakllin në qytet t'a marri.  
Ah, dashtë Jupiteri t'rroj'm' për herë  
Me gas me njani t'jetrin dhe me ndër  
Dhe ardh't' oraklli për të mirën t'onë,  
Për paq' n'lthakën t'ime për gjithmonë!  
Në ç'breng më suëll Penelopeja muë!  
Por s'dij se ç'kam dhe vet' sot; m'u kujtuë  
Dhe Telegon' i dashun se sa herë  
Me Circen, t'amën, at' hyjnesh' me vlerë.



Ah, ah pran' vehtes un kët' djal t'a kisha  
Sa dëshironja! Sa fatlum do t'isha  
Ahere! Zembrën do t'm'a lehtësonte  
Nga kto brengime dhe do t'më gëzonte,  
Se në shiëpi ahere do t'shikonja  
Dy bij të dashun, porsì dy bitonja.  
Moj Circ, dërgoje ktu, moj perëndeshë, —  
Se falënderoje gjithnji do të keshë  
Prej meje — sille ktu ti djalin t'im,  
Të cilin un e pres me aq gëzim.  
Këndeje n'lhakën t'ime ti dërgoje,  
Moj perëndesh' dashnore, dhe mësoje  
Si rrugën e atdheut ai t'a gjenjë  
T'atit të 'tij edhe a-dëj të vejë.  
Ah, sá t'kujtoj dhe ty, moj Circ', me mallë!  
Nuk do t'harròj gjersà të jemi gjallë!  
Ah, kúr i flas kto fjal' më ngjan si kúr  
Dhe lis e shkamb i merr vesht edhe gúr  
Dhe se do t'i kallxojn' Penelopés  
Qi shum' e pakënaqme do të mbes'  
Pastaj prej meje për çka un ligjrova.

#### PENELOPEJA

Qetsohu, búrr, se t'gjitha i ndëgjova.

#### ULISI

Ah, qysh? Ktu qenke ti? Sá mir' u bā  
Qi t'gjeta ktu, moj gruë, se për nji gjā  
Dëshronja t'flisnja un me ty. Rri pak;  
Afrohu edhe ti, o Telemak.

#### PENELOPEJA

Mā mir' t'largohem fare un, Ulls,  
Qi mos të trubullòj e mos t'bezdis!  
Kur Circen ti e paske dashënore,  
Pse s'ndejte prá me atë magjitore  
Por erdhe prap këtú? Sá jam gënjyë  
Deri nashti e vorfna un me ty!



ULISI

Mbretnesh', kso fjalësh un s'kam folë kúrr;  
Kush t'i ka than'? (Ah, ç'u trathtuësh!)

PENELOPEJA

Jo búrr,  
Kurkush nuk m'i ka than'; por vet' na ty  
Me Telemakun të ndëgjuëm të dy,  
Kúr fole ti për Çircen aq me flak'  
Të madhe të dashnís. O Telemak,  
Dijtsh perëndijt, na thuj ç'ka ti ndëgjove  
Prej atit tand.

TELEMAKU

Ah nan'; ç'ka ti kallxove.

PENELOPEJA

Ndëgjoje prá, Ulis.

ULISI

Dhe ti, o bír,  
Dhe ti qi un t'kam dijtë t'urt' e t'mirë  
Dhe ti të flaç në kët' mënyr' për muë?  
Ah, djal i ashpër!

TELEMAKU

Fort, o at, të duë  
Dhe për detyr' e kam qi të nderoj  
Shum' tepër, por nuk mundem të mohoj  
Përpara nanës fjalët qi m'ndëgjuën  
Muë veshët dhe qi zemrën m'a helmuën.

ULISI

Ç'fár' fjalësh të ndëgjuën ty veshët djal?

TELEMAKU

Qetohu, at, dhe fol pak mâ nga dal.  
Nga t'gjitha fjalët qi nga ti ndëgjova,  
Qi Circen shum'e dojshe un kuptova



Dhe qi me 'tê ti ke nji t' jetër bir;  
Kto fjal' m'ndëgjuën muë veshët fare mirë.

ULISI

S' kám fol' un fare kshtu, o Telemak,  
Por ti gënjen nashti.

TELEMAKU

O at, pa shkak  
M'a thuë at' fjal'.

ULISI

Ç'gënjeshtra po më thuë  
O bir, ti? Ah, por kush t' i ka mësuë?

PENELOPEJA

Shikò nji her' këndej: o burr, shikò,  
E veni fjalvet ré dhe më ndëgjò,  
Se jan' t' vërteta ç' Telemaku thotë,  
Prandaj ti mos i llit atij mb' të kotë.  
Ndëgjò nashti t' yt shoqe qi me besë  
Të ndejt aq vjet pa pasun as nji shpresë  
Për rrojtjen tande mâ. Sadoqi muë  
Ahere prá më patën dash' për gruë  
Se sà djelmosh' të rij ithakijanë,  
Por mbassi fjalën ty t'a pata dhanë  
Qi do të rrij me bes', nuk qesh martuë  
Me as ndonji, sadoqi qesh' kërkuë  
Prej t' gjithve. Kúr në funt u egërsuën  
Dhe dojshin të më marrshih me përdhunë,  
Ahere shih ç' u thash me dinakrí:  
„M' dëgjoni muë o ju djelmosh' të rij;  
Un do t' martohemi ahere, kúr  
T' a kemi sosë fare at' pëlhurë  
Qi për Laertin jam tyk' e punuë  
T' a veshi, kúr syt ka me ja mbuluë



Vdekja atij“. Edhè atà m' besuën,  
Të marrët, dhe as pak nuk m'a kuptuën  
Dinakërin; se ditën un ç'punoja  
N' pëlhurën natën prap e shkatarroja.  
Kështu tri vjet i paç gënjyë, por muë  
Nga shërbëtorët një më kish trathtuë  
Në funt, si vjet i katërt' kishte hyë,  
Se qysh i rrenja un u kish dëftyë  
Atynve; por ahëre ti n' atdhë  
Arrine, o Ullis pa bes' e fé,  
Se rishtas dinakri k sha me gjetë  
T' i mbanja un me fjal' atà të shkretë,  
Se mâ nuk donja un as një martesë  
Për me të ndejtun ty, o burr, me besë.  
Kështu e kam kaluë un rinin t' ime  
Për ty me t' game dhe me psherëtime,  
Se un, e vorfna un, kam pas' besuë  
Qi ti në dët kush din se ç' ke pësuë,  
Dhe nuk e dinja qi nëpër bregore  
Ke ndjek' një perëndesh' ti për dashnore  
Dhe qi me 'të ke bâ edhë fëmijë!  
Ah, qysh i sheh nashri ti syt e mij?  
Nuk ke pak turp qi rrin përpara meje,  
Një zemre aq të pastër qi prej teje  
Ndryshim të tepërm' ka?

ULISI

Kerkòn kët' shpatë  
Qi t'a përdor' mbi ty, moj gruë?

TELEMAKU

O at,

Ç'kerkòn të banjsh ti? Nanën t'lyësh me gjak?

PENELOPEJA

Ah lene, lene t' them', o Telemak,  
Qi krahanorin e s'at'am't'a shpojë  
Me shpatën qi nuk mundi kurr në Trojë.



Të çaj'me'tê kaptina trimash. Muë  
Kërkòn t'më presish, burr? Hâ prá; nji gruë  
E dobët jam; s'ka gjâ; por kurdoherë  
Kush grá ka vra nuk ka fitumun ndër.  
Kush vehten trim e quën ai me grát  
Nuk sillet kshtu tyke u nxjerrun shpatë  
Përpara porsí ti, por i nderòn  
Dhe vehtes nderin dhe mâ shum'ja shton.  
Ai qi trimin mâ të fort'e shpon  
Me shpat'në luft'dhe vdekja s'e frikòn,  
Ai qi sillet mir'me grát dhe ka  
Dashní për bijt e gruën e'tij pa prá;  
Ai asht trim me të vërtet', jo ti  
Qi don të preç t'yt shoqe, faqezi.

---

## SCEN'E KATËRTË

ULISI, TELEMAKU

ULISI

Ç'far'fjalësh qen' kto; ah, qysh i durove,  
Moj zemër? Gruë, më duket u marrove!  
Por ti, o Telemak, por ti ç'far'thoje  
Ashtu? Dhe ti asaj t'i ndihje doje?  
Asàj qi si e marr'më foli kot  
Me fjalë t'ashpra dhe me idhnim plot?  
Ç'i bana? Thuj; pse bani aq potere  
Dhe më bëriuste si nji gruë lapere?

TELEMAKU

Per perëndijt, o at, s'e kam besuë  
Qi kishje ti me qen'kaq shum'ndërruë  
Gjersa t'a ngrinje dorën mbi t'yt shoqe  
Edhë t'a vrisnje! At'qi kúr u poqe  
Për her'të par, kúr sose ktu n'atdhë  
Me mall e përqafoje, se e pé



Përsri! Përsè u solle drejt asàj  
Ti aq i egër? Sá i math ky faj  
Qi bane! Nana asht, me të vërtetë  
Të them, një gruë qi shoqe s' do të ketë  
Dhe s'ka me pasun kurr në botën mbarë.  
Shikò: ajò më thoshte muë qëparë  
Qi mundesh ti me nimfen Kilipsó  
Asè me Circen t'kishe fmij, me'to;  
Por un asàj i thash'qi t'i largojë  
Atò mendime, se nuk munt të dojë  
Një búr porsì Ulisi t'jera grá.  
Kúr ti po rrinje ktu ajò më tha  
Të rrijmë mbë një an'qi të ndëgjojë  
Ç'ka do të flisnje. Kúr e zune n'gojë  
Ti emnin Circ', ajò u zemëruë  
Aq tepër sà nuk mundi me duruë  
Pa t'folë, se s'i kishje ndejt'në besë  
Një gruje qi të pat në manj'të kresë.

### ULISI

Pse, djal, s'i paskam ndejt'në bes'? Kush tha?  
Kush tha, o djal i lik? Hâ, thujmë prà.  
I ashpër! Kshtu m'a mbajke nderjen muë  
Ti? S'sheh një her'Laertìn sà e duë  
Un, atin t'im? Sà tepër e nderó,  
Sa do qi vet'u plakësh e pò shkoj?

### TELEMAKU

Dhe un, o at, kujtoj qi s'kam munguë  
Dëshirat t'uëje prà pa t'i mbaruë;  
Por un s'e dij se ç'ke kështù ti sot.  
Na flet si muë ashtù dhe nanës kot....  
Të shkoj një her't'a shoh të mjerën ç'ban,  
Se iku plot zemrim. Ah ti, moj nanë,  
Qi prisnje aq me gas të math t'arrinjë  
Yt shoq shëndosh', t'përdorësh kúr të vinjë



Ai pastaj aq ligsht prej 'tij?! Për t' qá  
Me të vërtetë jeni ju, moj grá!

---

## SCEN' E PESTË

---

### ULISI

Nga ç'ruhesha në funt ajò më gjet!...  
U shash' dhe u shnderuësh! Dhe kush? Nji mbret.  
Si un qi fam' të shumt' në Troj' fitoi!  
Sâ fatkeqsí! Nashti muë m'i kuptoi  
Të gjitha nbshehtësit e zemrës s'ime  
Penelopeja; un fatziu! Ç'mendime  
Të ra m'a tresin trupin muë nashti!  
Nuk duë të kthehemi n'lthak' përsri;  
Ç'të banj? Penelopeja asht idhnuë  
Dhe kúrr s'besoj të bahet mir' me muë  
Ajò mâ. Ah, mjer un! Ah, ç'far' kërkoja  
Të banja un i marri? Gruën të shpoja?  
Penelopén të shpoja un me shpatë?  
Até qi m'priti muë nji koh' të gjatë  
Tyke më qa dhe tyke pas' brengime  
Në zemër? At' të priste shpat'e ime?  
Marri, marrí kam bâ; s'duë mâ të rroj  
Me faqe t'zez'; nga bota duë të shkoj!  
Minerv', moj perëndesh', nga ti pres shpresë-  
t'i zbusish zemrën dhe Penelopés!

---

*Fund' i aktit të dytë.*

---





# AKT' I TRETË

## SCEN' E PARË

### TELEGONI

Sá vend i egër! Sá me frik' vështroj  
Për rreth! Këndëj as një njeri s'besoj  
Të gjindet fare qi të më kallxojë.  
Ku jam dhe ç'quhet vendi t'më tregojë.  
Oh, ç'fat i lik! Sá vuëjtje! Shkoi një mujë  
Të thuësh qi veç udhtoj un nëpër uj  
Për t' gjetun atin ku ai banòn,  
Në ç'pjes' të dheut ai me fam' sundòn;  
Por kot, se fati ktu më suëll; arrina  
Në këtë vend të shveshun plot gremina.  
Ah, at i shtrenjt! Të kishja qi të dinja  
Se si n'lthak' udhtohesh, do të vinja  
Me koh' me qen' ke ti për t'pá me sy,  
Se shumë po breth' për me t'kërkumun ty.  
Ah, mjer atà qi lark prej prindvet rrojnë!  
Sá jam' për t'u vajtuë! Me helm e çojnë  
Të vorfnit t'bukrën koh' të djelmënis!  
Por lum atà qi prakmit të shtëpis  
S'iu kan' largumun kurr, se kan' shijuë  
Dashnin familjare tyke rruë  
Së bashku vllá e motër tok të tanë!  
Por un ç'të banj këndej nëpër kto anë  
Nashti i vetëm? Ah, ndonji armik  
Po m'ra mbë qaf', për perëndijt më fik  
Muë pa dyshim këndëj, se armë s'kam  
Të mprohem; ah në ç'gjendje t'keqe jam!  
Muë veç një halë peshkú t'madhe m'dha  
Kúr ika nan' e ime dhe më tha



Qi me atë të mprohem, kúr t'më binte  
Mbë qaf', ndokush dhe vetëm të më gjinte.  
Por ndonse asht me helm, s'besoj t'mjaftojë  
Qi një anmik të fort' për dhé t'a shtrojë.  
Prá qysh të banj? Të kthéhem prap? Jo; s' duë  
Pa marrë vesht ku jam, por me takuë  
Ndonji njeri dëshroj, për me më thanë  
Si quhet kjo ujdhes' dhe gjith' kto anë.  
Pastáj muë nana m'tha mos t'i kallxoj  
As një njeriu kush jam e ku banoj,  
Se ndoshta asht anmik'i atit t'im  
Ndonji dhe mbi të birin merr shpërblim.  
Jo, jo: ashtu do t'banj, si nana muë  
Më porositi; s'duhet me kallxuë  
Se cili jam. A t'shkoj? Po, po; nashti  
T'i hypi un anijes përsëri  
Dhe t'udhëtoj, se deti asht i qetë.  
Ky vend më duket muë të jet'i shkretë  
Pa far' banuësi. Ah, më ngjan kaloi  
Dikush këndëj tash... nëpër sy më shkol...  
S'po duket mâ. T'a thrres; s'do humbë kohë;  
Le t'jet' kush t'jet', s'ka gjâ se nuk e njoh.

## SCEN' E DYTË

TELEMAKU, TELEGONI

TELEMAKU

Ti më thërrite, o njeri i huëj,  
Ashtu muë? Ç'far' kërkôn prej meje? Thuëj.

TELEGONI

Të thrrita un, o mik, ty; un i shkretë  
Qi t'më tregojsh ku jam dhe ç' quhet mbretë.  
I ktyne anëve, në qoft se ka  
Përveçse teje njerës edhë mâ,



Të cilët e banojnë kët' ujdhesë.  
Ah, mik i dashun! Un nuk kisha shpresë  
As fare qi të gjenja ktu njeri.  
Fol prá, më thuëj ku gjindem un nashti.

### TELEMAKU

Ti je n'lthak', Ulisi ku sundòn  
Nashti, o djal.

### TELEGONI

Ah, mik, ç'far' po kallxòn!

### TELEMAKU

Pse, djal, gëzohe ti? Këndëj ndonj' herë  
Ka qen' yt at dhe mbretin t'on' me vlerë  
Ndoshta e njeh, se në fëtyr' të pashë  
Qi u gëzove tepër, kúr të thashë  
Se ash rrenuës i Trojës ktu Ulisi,  
Sunduës i vendit, mbret i këtij fisi?  
Më thuj dhe ti prá, djal, në ç'vend banòn?  
Nga ç'popull je dhe cili mbret sundòn  
Atje ke ju? Pastaj duë me m'kallxuë  
Dhe qysh u gjinde vetëm ti këtù,  
O djal, se ti s'më duke t'jesh' barbar,  
Porse prej racës s'on'.

### TELEGONI

O shpetimtár —

Sepse ashtù të quëj, mbassi m'kallxove  
Ti vendin ku po gjindem — mir' qillove  
Se un nuk jam nga ndonji skot' barbare:  
Adheu i em asht një ujdhes' detare:  
Nga Kreta jam un prá, o mik i mirë,  
Por muë këtù më suëllën me pahirë  
Disà anmiq edhë të lidh' më lanë,  
Pastaj u nisën prap e mâ s'u panë.



Un jam prej nji familje t'pasje vetë  
Edhë im at ka ndejtë veç në Kretë,  
Kurr rronte edhë kurr nuk ka udhtuë  
Në dët qi dhe këndëj të ket' kaluë  
Nëpër Ithak' të themi: por ndëgioj  
Për nji Ullis gjithmon' të bisedojë  
N'atdhë njerzija, se me mbretin t'onë  
Në Troj' kan shkuë së bashku për gjithmonë,  
Mbassi edhë Idomeneu kish shkuë  
Në luft', Atridëvet për t'u ndihmuë.  
Kurr un prej teje, mik, pastaj ndëgjova  
Qi jam n'Ithak' shum' tepër u gëzova,  
Se pres shpëtim un prej sunduësit t'uëj.  
Por si të piqem un me 'të? Më thuëj  
Ku asht, të lutem, udha drejt qytetit  
Dhe si t'a gjenj pastaj pallat' n e mbretit,  
Kurr t'sos atje?

### TELEMAKU

O djal, ti mos mendohu  
Përmbi kët' gjã as fare, por gëzohu,  
Se fati ty këlu ke na të pruë  
Dhe se me njer's miq pritës ke qilluë.  
Un sonde do të nisem për n' qytet,  
Se qytetar, o djal, jam dhe un vetë  
E ti mundesh të vinjsh me muë dhe ty  
Pallat' n e mbretit kam me t'a dëftyë  
Un vet' pastaj atje porsa të sos  
Dhe mbassi n' rregull pllaçkat t' i vendës.  
Por, më kallxò nashti, o djal, ç' far' thonë  
Bashkatdhetarët t'uëj për mbretin t'onë;  
Si flitet për atë, a e lavdojnë  
Ndo pak, a po as fare s'e kujtojnë;  
Se ti më the muë vet' qi ke ndëgjuë  
Se mbi atë në Kret' ka biseduë  
Njerzija.



TELEGONI

Mik, në qoft se asht ai  
Qi për të cilin bahet fjal' gjithnji  
Në vendin ku kam lemun un, në Krete,  
Sunduës e mbret i juëj me të vërtetë,  
Ahere ju banuësit për t' u mburrë  
Prá jemi për at' mbret qi s' do, t' vinj' kurr,  
Sikundër thon' ke ná, në botën mbarë.  
Kallxojn' se paska qen' gjithmon' i parë  
Ndër mbledhje për me dhan' këshilla n' Trojë,  
Kúr ndonji herë trimat pan' nevojë;  
I dyti paskish qen' një plak me vlerë,  
Nestori, qi nuk fliste kurr ndër erë.  
Por mbas Akilit dhe Ajacit qe  
Dhe Diomedi bashkë rre atë  
I zoti për t' kallxumun trimin  
Dhe kshtu t' lavdohet në të gjith' ushtrinë.  
Pastaj kallxojn' ke na se si shkatërroi  
Qytetin e Priamit deshi t' shkojë  
N' lthak', n' atdhën e dashun përsëri,  
Për t' pa Penelopen, gruën fjesht bukrí;  
Por Dielli atëhere shok' t' e shkretë,  
Mbassi i therën lopët, t' gjith' në dët  
Ja mbyti edhë fill i vetëm mbeti  
Ullis' i shkretë, por në funt e gjeti  
Mënyrën qysh t' a shohi prap atdhën  
Dhe rishtas t' përqafoj' Penelopén;  
Se një hyjnesh', të cilës Circ' i thonë  
Dhe prej të cilës frik' kan' pas' gjithmonë  
Të vdekshmit t' jer', atij i ka kallxuë  
Për t' sos' n' lthak' qysh duhet me udhtuë.  
Me këtë hyjnesh' një vit te tan' banoi  
Sunduës i juëj dhe plot me gas e shkoi  
Ai këtë koh', se dashuní i solli  
E shenjta Circ' atij edhë e polli  
Me t' pastaj një djal' qi Telegòn  
E quëjti dhe qi n' shpell' të saj banon.



Kshtu flitet pra, o mik i shtrenjt', gjithmonë  
Përmbi Ullisin t' uëj në Kretën t' onë;  
Por s' dij a jan' t' vërteta gjith' kto fjalë?

#### TELEMAKU

T' vërteta jan' të gjitha ç'thë, o djal,  
Kto gjâ i dijn' të tan', por na gëzohet  
Mâ tepër zemra po të na lavdohet  
Përyshla mbreti kshu si ti na thé.  
Sa mir' të ndihu fati qi n' kët' dhé  
Të suëll, o djal; sepse në funt shpëlove  
Nga ç' do rrezik i detit dhe qillove  
Në tokën e Ullisit, qi shum' mirë  
Kujtoj do t' presë dhe do t' ket' si bir,  
Sepse për' të shum' fjal' të bukra thé  
Dhe se prej dheut t' Idomeneut ti jé.

#### TELEGONI

○ mik i dashun, un nji plak njeri  
Po-shoh qi vien këndëj; kush është ai?

#### TELEMAKU

Nji plak fatzi, o djal, qi vetëm rron  
Dhe tyke bredhë jetën e kalon;  
As bir, as bij' nuk ka, por veç gjutija  
Asht gazi për atë edhe lumnija.

### SCEN'E TRETË

ULISI, TELEMAKU, TELEGONI

#### ULISI

Ah qysh? N' lthakën t' on' të vijn' të huëj  
E të grabish? Ç' far' jan' prindnit t' uëj  
Dhe ku banojn' atë me ty, o djal?  
Ti bir kusari m' duke t' jesh për fjalë



Se me kët' veshje dhe fëtyr' qi ké  
Nji vrrag' të keqe tepër muë më lé;  
Por qysh? S' e din ti qi në vendin t' onë  
Të shtrejt' mbretnòn ai qi n' llion  
Mbi Grekët t' jer' çudi të mdha ka lanë?  
S' e din ti ai eundon kto anë  
Dhe nuk shpëtoni kurr nga dor' e 'tij  
Po të grabitni, o kusar' të rij?

#### TELEMAKU

S' e kemi na kusar' kët' mik, o plak,  
Por mbaje ti durimin edhë pak,  
Se ky asht djal' i mir' dhe rron në Kretë;  
Se Jupiteri her' n e par' ktij jetë  
Atje i dha dhe prindnit po atje  
I rrojn'; por ti ç' ka kë kështu më kte?  
I vorfni u gëzuë kúr më ndëgjoi  
Qi i kallxova se n' lthak' qilloi.

#### ULISI

Kush ky të jet' nga Kreta? Ky të jetë?  
Dhe muë do t' më gaboni, o të shkretë?  
Të dy gënjeshttra flitni; fjesht djallzi  
E keni zemrën ju, djelmosh' të kqij.  
Un sot u thinja mâ; mirpo në Kretë  
Kur më lulzonte mosha kam qen' vetë  
Dhe mir' e dij si vendësit ndërrohen,  
Me ç' petka dhe me ç' ndreqje lulëzohen.  
Por un të them qi ti je një kusar  
Qi vjen me na grabit', o djal i marrë.  
Largohu prej këndëj me t' shpejt' po t' them,  
Se ndryshe do t' çoptoj' ky krah' i em.

#### TELEGONI

O plak. ti m' fole tepër ashpër muë  
Pa ndonji shkak. Nashti a nuk më thuë  
Ç' marri t' a kapi trun e vyshkët krejt  
Qi pa një shkak u zemërove shpejt



Dhe si një shërbëtor ti më qartove?  
O plak i keq, me ke po flet harrove?  
Kujtove ti se kishje me m'frikue  
Me fjalët aq të poshtme qi m'the muë?  
Por nxene, se ndonse pa arëm jam,  
O plak pa turp, un frik' prej teje s'kam.  
Dhe po t'a themi prap qi nuk frikohem  
Nga shpat' e jote sa qi të largohem.  
Un nuk kam ardh' këtù për me grabitë,  
Si thuë, — ah mos e thançin perëndijt  
Të banj kso gjâsh un — por kam ardh' për t' mirë  
Dhe mbret' i juëj t' më shohi ka dëshirë  
Kujtoj dhe do t'qertoj' qi m'fale muë  
Me kët'mënyrë t' ashpër ti kështù,  
Se un do t' i kallxoj një gjâ të mirë  
Atij dhe ti rri urt', o plak i vshtirë,  
E mos fol mâ, se më mërzite fare.

### ULISI

O djal i lik prej skote krejt barbare,  
Ti pa dyshim me prindën t' poshtun rron,  
Se gjuh' e ashpër tandja t'a tregon  
Qi pa arsim e sjellje ti je rritë  
Dhe s'din gjâ t' jetër veç se me grabitë  
Por nxene, djal i poshtun, ku qëndrôn;  
Ktu asht lthaka edhe mbretlënôn  
Ulisi qi shok t' jetër n' bot' s' do t' ketë.  
Këtù ke na i riu duhet të jetë  
I bindshëm kundrejt pleqvet për gjithmonë,  
O djal kusar, kshu duhet n' vendin t'onë:  
E ti t'më banjsh muë një të lill fëtyrë  
Të vrazhët dhe t'më flasish n' at' mënyrë?  
Kshu t'ka arsyë jot am' ty dhe yt' at'  
Përpara pleqvet t' kesh' një gjuh' si shpatë?  
Kshu asht ojtnij' e vendit, a s'më thüë,  
Qi të shnderohen pleqt atje ke ju?





Ah, ndonse edhë je një djal i ri,  
Por goja ty t'a bani, mot ditzí,  
Qi porsí një burbuqe krejt pa çelë  
Ke Hadi t'shkojsh edhe atje me ngelë,  
Se Dielli tash për ty do t'perëndojë,  
Për ty dhe jet'e ambël do t'mbarojë,  
Mbassi kjo shpat' e ime ka me t'pré,  
Për ato fjal' qi m'fole ka me t'ndé  
Për dhé pa shpirt. Pësoje, djal i lik,  
Se ti m'u bane fort një math anmik.

### TELEMAKU

Qëndrò të lutem, ah qëndrò një herë  
Dhe më ndëgjò ç'të them; m'a ban këtë ndër.  
E shoh qi fjalët fort u ashpëruën,  
Por të dy palët kot u hidhëruën.  
Ti më i vjetër je edhe kuptòn  
Qi ky asht djal i ri dhe nuk mendòn  
Ç'far' flet, kúr zemrën ja ngufmòn zemrimi  
Dhe vehten kúr nuk ja urdhnòn mejtimi.  
Ai pse t'foli ligisht ty ka shum' faj,  
Por edhe ti nuk duhet mbasandaj  
Qi më i vjetër dhe i mendshëm jé  
T'i marrish jetën një bitonje t'rë,  
Qi ende nuk asht rrah në shogëni  
Dhe s'din se me këdo të kesh' miqsi  
Në botë mbar' asht gjanja më me vlerë.  
Prandaj qetohu prá, o plak me ndër,  
Përmbaje vehten ti dhe mos u sill  
Me kte i egër; fute shpatën n'mill,  
Se hije moshës s'ate nuk i ka  
Të jesh' gjakpirës, njerës për me vrá.  
— Dhe ty kujtohu t' them, o djal i huëj,  
Qi ktu s'po flet me shërbëtorët t'uëj.  
Ktu je n'lthak' edhe me njerës t'vjetër  
Ti duhet t'flasish me mënyrë t'jetër.



Kundrejt atyneve ti duhet t'jeshë  
I urret' dhe fjalën kurdoher' me peshë  
Lypset t'a flaç, se ktu kshtu asht zakoni  
Dhe ju të hujët duhet t'a mësoni.  
Prandaj largohu ti qi je i ri  
Dhe bani mâ të vjetrit udh' nashti;  
Largohu qi kjo grindje shpejt të shuhet  
Dhe në qytet për ngjarje mos të quhet,  
Se mbreti mbasandaj ka m'u zemruë  
Dhe n'vënd qi t'presi mir' ka me t'dëbuë.

### TELEGONI

Muë m'duhet të ndëgjoj, o mik i mirë,  
Dhe m'duhet t'a përmbush ty at' dëshirë  
Qi ke, se për bâmirës ty të njoh,  
Mbassi m'tregove muë kët' vënd qi shoh.  
Ti muë më duke t'jesh nj'i mendshëm djal,  
Se na turpnove t'dyve na me fjalë;  
Prandaj un'po largohem e po shkoj,  
Pse s'duë këtù njeri të zemëròj.

### SCEN' E KATËRTË

ULISI, TELEMAKU

TELEMAKU

Ç'far' pate, at, ashtù qi e turpnove  
At' djal'n e huëj? Sá ashpër e shnderove  
Me fjal' të randa pa të bamun gjâ!  
Nuk asht mëkat' e turp për ty kjo prá  
Të sillesh keq me bujtësit qi t'vijne  
Në vëndin t'and dhe gas të tepërm' ndijnë,  
Kúr marrin vesh qi je ti mbret këndëj,  
Se fam' e jote ndihet tëj e tej?



ULISI

O djal trathtór, un bir ty mâ s'të quëj.  
Un ty mâ shum' se sa at' djal' e huëj  
Të kam mëni dhe s'duë të shoh me sy,  
Se deri tash me ty un jam gënjye.  
Prandaj largohu t'them 'prej vendit fare  
Dhe arratisu në ndonj' tok' barbare.  
Ku të pëlqejë shko, por vetëm ktu  
N'lthak' ti s'ke vend; lark se nuk të duë.

TELEMAKU

Ç'asht shkaku, at, ç'far' bana un i shkreti?  
Mbë ç'faj më gjete? Ah, por ç'vler' i mbeti  
Mâ rrojtjes s'irne lark po t'jem prej teje?  
Kaq ligisht të sillesh, at, ti kundër meje?  
Por thuëj, të lutem, shkakun; thuëj përsën.  
Ç'asht kjo mëni e madhe qi po lenë  
Kaq shpejt nashti prej teje? Si me muë  
Edhë me nanën je ti sot idhnuë  
Sa doje qi t'a vrisje fare kot.  
Ah, ti po m'ban muë qi të derth tash lot!

ULISI

Po, po, o tradhëtór, ti dashuni  
Për muë nuk' ke as fare, por djallzi  
Stërvit në mendjen tande. Psho mos qaj  
Të them, se më zemrën mâ shum pastaj  
A din ti, o shpirtlik, se shërbëtori,  
Qi shkoi në tempël dhe orakllin móri,  
Ç'far' lajmesh të trishtuëshme më ka pruë?

TELEMAKU

Ç'far' lajmesh pruë; hâ m'a kallxo dhe muë.

ULISI

Më tha qi vdekja muë ka për me m'gjetë  
Prej dorës së t'im biri, t'cilit vetë



I kam pas' dhan' un jet' e drit' botnore  
Kshtu paskan tjerrun Parcet punëtore,  
Gjakpirës i t'yt et; largohu, ik,  
Se ti s'je mâ im bir, por nji anmik.

### TELEMAKU

Gënjejn' hyjnit, o at, gënjejn'; m'besò.  
Se ty s'të vret yt bir. O mos m'dëbò!  
Un ty të duë mâ shum'. se jetën t'ime!  
Qysh prà të vras ty? Ah, por me ç'qëllime?  
Ah, qysh zen bes' kso gjanash ti, o at?  
T'më banjsh qi t'qaj pa shkak a s'asht mëkatë?

### ULISI

Prej meje lark të thëm; fjal' t'jera s'duë.  
Nashti shko shpejt gatitu për t'udhtuë,  
Se, si të thash', ti vend n'lthak' nuk ké;  
Ti duhet t'shkojsh prej vendit ku kë lé.

### TELEMAKU

O perëndij; ah un, i vorfni, un!  
Ç'asht gjith' kjo fatkeqsi, ah ç'asht kjo punë!  
Nga ç'an' të nisem, ah nga ç'an' me shkuë!  
O Jupiter t'thërres për me, m'ndihmuë!...

### SCEN' E PESTË

### ULISI

Sa vjen mâ tepër' nxehem e idhnohem.  
Ah, qysh? Prej Telemakut të trattohem?  
Prej 't'ij qi vet' e pata pjell' e rritë  
Dhe si nji qinq un t'urt' e pata dijtë?  
O bot', qysh je ndërruë, qysh je këthyë;  
Ah, si më hypën muë marrija n'kryë!



Muë m'erren syt nga zemërimi, oh,  
O bir i lik, un ty s'të paskam njoh'!  
Ku âsht ndëgjuë dhe ku âsht pa, në ç'anë  
Të dheut, qi dor' e birit t'vrasi t'anë!  
Përveç Orestit s'kam ndëgjuë un mâ  
Qi at e nan' ndonji fëmiij' t'kët'vrá.  
Por ti i dyti je, o Telemak,  
Qi ndoqe shembillën e atij pa shkak.  
Ah, gjersa t'jemi gjall un ty s'të duë  
Të shoh me sy mâ fare; qofsh mallkuë!

---

*Fund' i aktit të tretë.*

---



# AKT' I KATËRTË

---

## SCEN' E PARË

---

### ULISI

O nga një her' sa t' zeza ditët gdhijnë  
Për njerzit, por më shumë për muë fatzín!  
Ja sot; të gjith' prapsinat më kanë ndjekë:  
Im bir kërkonte me më lan' të vdekë  
Pa as një shkak dhe gruëja është idhnuë,  
Se kurr kam fol' për Cirën m' ka ndëgjuë.  
Oh, un i marri ç' far' kam dash' me bân:  
Kurr më qertoi u derdhësh për t' a vrá!  
Kshtu është njeriu kurr nxehet, s' din ç' ka flet:  
S' mendon dhe ç' është tyk' bân, por vret e pret.  
Oh ç' turp për shkallën t' ime, ç' turp pa masë!  
S' kam sy e faqe më njeri me hasël...  
Por ktu s' e shoh un më at' djal'n e ri,  
Qi më shnderoi qëpar' muë fjesht idhni.  
O perëndij, ju lutem m' a mësoni  
Po që ai djaloshi Telegoni,  
Se munt qi dhe ai më del trathtór  
Muë, djal' i lem' prej nane pa kënorë:  
Ah qysh t' a shoh këndeje edhe një herë,  
Se duë në shesht t' vërtetën më ja nxjerrë.  
Ah, ja ç' kërkoi; ja ai afrohet;  
Sà hapa hjetë muë zemra aq m' ngufmohet!

---



## SCEN' E DYTË

TELEGONI, ULISI

ULISI

Eja, o djal, afrohu; na u shamë  
Qëpar' të dy, por mir' të dy nuk bamë.  
Un plaku mir' nuk bâna qi fillova  
Pa marrë vesht kush je dhe të qertova,  
Por e jhë ti lypsesh t' më banje udhë,  
Se je i ri, lëkura nuk t' âsht rrudhë,  
Dhe un kujtoj kudo kshtu âsht ojtnija;  
Prandaj mos u zëmrò nga fjal't e mija.  
Por na t' i lam' mbë nj' an' kto fjal' nashti;  
Ti muë m' kallxò t' vërtetën, djal i ri,  
Nga ç' vend ke ardh' dhe cilin ke atdhë,  
Se un besoj qi ti prej Krete s' je.  
Kallxò t' vërtetën, djal, dhe mós kij frikë;  
Ti po t' mohojsh atdhën bân pun' të ligë.

TELEGONI

Nji her' t' kallxuën, o plak, t' jetër ç' të themë?  
Veç Kretës nga ç' vend t' jetër munt të jëmë?  
Sekur edhë mos t' isha do t' kallxoja;  
Nuk do t' gënjenja kurse s' ish nevoja.  
Por dhe kusar nuk jam sikundër thé,  
Se arëm don kusari per me pré  
Dhe muë s' më gjinden, ridonse kam nevojë,  
Dhe s' mundem me u mprojtun pa at' llojë.  
Por shkurtazi ç' të duhet ty kush jam  
Dhe prej ç' far' ane prindënit i kam?  
Un ty nuk po të pyës se cili je,  
Së s' duë këtyne gjave m' u vuë ré;  
Prandaj t' i lam' na mâ kto bisedime.  
Largohu, ik' më len në punën t' ime.



## ULISI

Jo, djal; këndej s'largohem pa m'dëftjë::  
Kush nan' të lindi dhe kush t'ka arsyë,  
Dhe ju të huëjët duhet n'vend të huëj  
T'kallxoni farën edhë fisin t'uëj,  
Se ndryshe gjâ të lig' për na mendoni,  
Kúr ju prej ç'vendi jeni të mohoni.  
Hâ, djal, më thuëj prá, bjeri të vërtetës::  
Nga vjen, se ti nuk je banuës i Kretës?  
Nga ç'nan' për t'parën her' ke pi ti sisë.  
Dhe kush të tundi n'djepet t'vogëlnis?  
Ti muë më duke t'jesh' një djal' i mirë;  
Hâ prá, dhe muë përmbushma kët' dëshirë..  
Kallxoma cilët prindën t'prun' në botë  
Dhe mos më loth kështù muë mbë të kotë.

## TELEGONI

Ç'kërkón prej meje kshtu ti, o njeri?  
Përsë nuk ikën, por më jep mërzi?  
Kush t'jem le t'jem un, ty s'të hyn' në punë  
Të dijshe prej ç'vendi vinj dhe kush jam un.  
Dhe me shërblorin tand në kët' mënyrë  
Të flaç nuk të duron, se për detyrë  
E ka qi të shërbejë për ç'do gjâ,  
Por jo t'i apsh mundim kështù pa prá.  
Largohu, mik, të them dhe mos më pyët  
Mâ tepër, se prej t'nxemes po m'dhëmb kryët.  
A je Ulisi ti dhe e sundón  
Kët' vend qi muë të më mendojsh kërkón?  
A je ti ndoshta burri qi në Trojë  
La shum' çudí, gjersa e shkatarroj,  
Se vehten ti si mbret po e tregón  
Dhe kot të huëjët t'i mendojsh kërkón?  
Un ty as s'duë të dij' se cili jë,  
As vesh s'të venj për fjalët qi më thé,  
Prandaj të lutem ik, o plak i mirë,  
Dhe në qetsí më len, se jam i lirë.





E jo një skillav që t' më mundojsh kaq shumë;  
Un jam një bir prej ati shumë fatlum.

### ULISI

Do t' më kallxojsh prej ç' vendi je a ç' thue?  
Dalloje shpejt dhe mos më mba ktu muë,  
Se edhe un s' jam shërbëtor i ty,  
Që të mundohem ktu tyke të pyët.  
Dhe un që ty të ngjaj një plak pa vlerë  
Nga një shtëpi e madhe jam me ndër,  
Prandaj kallxoma emnin s' më shnejt:  
Ç' të quajn dhe prej ç' far' vendi vjen dhe drejt.  
Kshtu asht ojnija ktu në vendin t' onë,  
Për t' huëjët dhe Ulisi kshtu urdhnon  
Që më përpara se të hyjn' n' qytet  
N' pallat' n' e tij — kushdo që munt të jetë —  
Nga vijn' prej ç' ane t' dheut duhet t' kallxojnë  
Dhe prindënit e tyre t' i emnojnë.  
E pra kush je? A don me më dëftye?

### TELEGONI

Or ik, largohu po të them un ty,  
Se më mërzite mjaft deri nashti  
Me fjalët t' uëja krejt pa randësi.  
Se ç' far' njeriu ti je un s' e kuptoj,  
Me njers' s' të till un s' duë të bisedoj,  
Që flasin tridhit her' një fjal' pa prâ  
Dhe pyësin mb' një e mb' dy po për një gjâ.  
Nashti m' u hiq e ik, o plak po t' them,  
Se për hyjnit muë koka po më dhëm.

### ULISI

Dhe një her' po t' pyës; a do t' më thuesh kush je  
Nga ç' an' po vjen dhe cilët prindëni kë,  
po do t' fusish vehten tande n' lak?



## TELEGONI

M'ur'hiq u qafet po të them, o plak;  
Ç' mësova keq me ty kështu un sot  
Qi m'vjen e m'bie mbë qaf' muë fare kot!

## ULISI

Shum' mir; dhe un po ikij prej këndëj,  
Dhe do të shkoj n' qytet qi t' i dëftëj  
Ulisit, mbretin t' on', qi nji kusar  
Ka ardh' n' lthak' t' i bahet pjesëtár  
I dheut edhe i pasunis së shtetit.  
Un ty të njoh qi ti je kunder mbretit  
Dhe ktu ke ardhë për të vrá atë,  
Prandaj po shkoj qi t' a lajmëroj, t' banj bé.

## SCEN' E TRETË

### PENELOPEJA, TELEGONI

#### PENELOPEJA

Ç' mendim i lik mbi krye t' rrotullohet,  
O djal, qi bukurija s' të mohohet?  
E shoh qi clp' e faqevet t' kulluëme  
Asht skuqun krejt nga zemra e idhnuëme.  
A mos ty plaku qi këndëj kaloi,  
Të foli ashpër sá qi t' zemërojë?

#### TELEGONI

Ç' fëtyr' e papandehun m'vjen muë n'fat?  
O perëndij, n' lthak' kshtu qenkan grát  
Qi faqe burraveq pa turp, të vijné  
Dhe nderin qysh t' a ruëjn të mos t' a dijnë?  
— Ç' kërkon prej meje ti më thuëj, moj gruë;  
Qi pa më-njoftë m' del përpata muë?



### PENELOPEJA

S'kërkoj prej teje ç'farë, o djal i artë,  
Por duë të dij ç'farë gjaje t'a ka çartë  
Qetsin e trupit tand porsi mermër.  
Të lutem hâ m'kallxò, m'a ban kët' ndër:  
A mos ty plaku qi këtù tash që  
Të foli ashpër? Kte prá më dëftë.

### TELEGONI

Un me atë ligjrova mir' nashti  
Dhe ashpër s'foli ndërmjet nesh as nji;  
Por dhe sikur të flitshim, ti pse pyët?

### PENELOPEJA

Pse është mëkat' qi muë t' më shohin syt.  
Fëtyrën tande t'kuqe asë t' zbetë  
Dhe shkaku nji njeri i till të jetë.

### TELEGONI

Moj gruë, ti me kto fjal' muë po m'turpnòn.  
Çfarë don të thuësh me kto ti? Ç' dëshiròn?  
Ti paske ardh' këtù me m'dhan' tristim!  
Un isha vetëm dhe për fatin t'im  
Mendohëshâ, qi n'kët ujdhes' më pruë  
Dhe se nuk dinja si me udhëtuë  
Qi në qytetin e Ithakës t'vinje  
Edhë pällátin e Ulisit t'gjinje,  
Se muë, si mbret qi asht, do t' më ndihmonte  
Dhe brengat zëmtrës do t'ja lehtësonte;  
E ti më vjen edhë më thuë ca fjalë  
Qi s'e marr vesht as pak se qysh t'kan' dalë?  
T'largohem un këndëj sepse, e quëj  
Për turp qi t'bisedoj me nj'gruë të huëj.

### PENELOPEJA

O djal, kët' ashpërsi qi po m'tregòn  
Ti muë kujtoj qi zemra nuk t'a don;



Dhe s' duhe qi një kryenaltësi,  
Kundrejt një grëje t' ket një djal i ri,  
Sá qi prej saj t' largohet e të shkojë,  
Kurse e shkreta don qi t' i ndihmojë.  
O djal hyjnór', kries' Olimpí, ty  
Jo vetëm udhën kam me t' a rrëfyë  
Si shkohet në qytet, por për me t' sjellë  
Mâ me sigur un vet' do të përcjellë  
Deri n' qytet, n' pallat' n e nalt' të mbretit,  
Se s' duë të lanj këndëj ndër buza t' detit.

### TELEGONI

Qysh? Ti do t' më përcjellish muë? Ti vetë?  
Me ty të shkoj un deri në qytet?  
Ah, mos e thançin perëndijt kët' gjã.  
Një mashkull nuk përzihet kurr me grã  
Të huëja qi për udh' t' i shoqënojë,  
Sadoqi dhe për 'ta munt t' ket' nevojë  
Jo, grë, të falmi nderjes; jo, nuk duë  
Qi t' më përsjellish deri n' qytet ti muë.  
Mâ mir' këndëj rrij vetëm me brengime,  
Se sã t' i venj një njoll' un faqes s' ime.

### PENELOPEJA

I egër kaq, o djal, ti s' duhet t' jeshë  
Përpara meje dhe kso zemre t' keshë,  
Se sã mâ shumë t' a mbajsh kët' kryenaltësi,  
Un aq mâ tepër kam me ran' n' dashni  
Ke ti....

### TELEGONI

O ç' turp për ty edhe për muë  
Kusk t' a ndëgjoll! Ç' far' fjalësh jan' kto, grë?

### PENELOPEJA

E shoh qi ty të bukur t' kan' krijuë  
Hyjnit dhe sjellje t' mira t' kan' dhuruë,



Por për ket' gjâ dhe muë pa randësi  
Të mos më marrish ti, o djal i ri,  
Se jam prej një shtëpije t' madhe un.

TELEGONI

Eh, mir' se je; por muë ç' më hyn' në punë?

PENELOPEJA


Të flasish mâ me t' but' ti nuk po dôn;  
Më thuëj nashti muë pra ç' ka dëshirôn  
Prej meje, se një t' mir' të banj po duë;  
Më thuëj për ç' gjâ mundem me të ndihmuë.

TELEGONI

Një gruë një burri s' mundet t' i ndihmojë  
Për atë gjâ që munt të ket' nevojë  
Ai, prandaj prej teje që s' kërkòj.  
Për fjalët që më thë të falnderòj  
Un shumë, por dhe sikur të dëshiroja  
Ndonj' gjâ, prej teje s' mundesh t' a fitoja.

PENELOPEJA

Pse jo; fol, djal, ç' kërkôn prej meje? Ç' gjâ?  
Ti sheh që un të pyës gjithnji pa prá.  
Kur erdha ktu ty fare vetëm t' pashë,  
Prandaj muë m' erdhi keq dhe fjalën t' dhashë  
Që për të gjitha gjanat do t' ndihmoje  
Dhe mâ në funt do t' çoje ku të doje;  
Por ti nuk deshe dhe un s' kam ç' me bâ.  
Nashti më thuëj të paktën ç' asht kjo gjâ  
Që për të cilën, djal, ti ke nevojë;  
Hâ prá m' a thuëj tash; ç' ile pak at' gojë,  
Se turp nuk asht t' kërkosh çka të mungôn.  
Udhtar je ti; më thuëj çka dëshirôn,  
Se ndoshta mundem me t' a dhan' un vetë.



TELEGONI

Nji hark më duhet muë dhe një shigjetë.

PENELOPEJA

Nji hark e një shigjetë të duhet ty?  
Për ç'pun' i don a mundesh me m'dëftjë?

TELEGONI

Për ç'pun' i duë? Asht pyëtje kjo qi thue?  
Për ç'pun' i lypsen burrit armët, gruë,  
Përveçse vehten t'mproj' kundrejt anmikut  
Dhe t'i largohet kurdoher' rrezikut,  
Asë të shkoj' ndër male dhe të gjuhë,  
Kurr' nuk e nget njeri në vend të huëj?  
Ti sheh qi un në moshën kam arrë  
Sa qi shigjetën n'harkun me e shti.

PENELOPEJA

Shigjetën edhe harkun po t'a ap  
Por duhet edhe ti t'm'a apsh me vrap  
Muë fjalën qi do t'banjsh çka un t'kërkoj.

TELEGONI

Mâ par' më thuëj ç'far' don qi t'a mendoj  
Se munt të bahet dhe të them pastaj  
E banj a jo qi mos t'më quhet faj  
Muë ç' do përgjigje qi e kam zakon  
Me dhan', se grat kërkojn' t'pamundshmet thonë.

PENELOPEJA

Un duë të vinj me ty në vendin t'at,  
Atje ku rron' jot arm' edhe yt at,  
Se duë të jem pran' teje për gjithmonë;  
Prandaj, kurr' t'ikish prej lthakës s'onë,  
Më merr dhe muë me vehte, se për nder  
Të math kam për t'a qujtun kurdoherë.




Me ty kam un dëshir' të madhe t' rroj  
Dhe jetën po me ty duë t' a mbaroj.  
Më merr me vehte, mos më len këndej,  
Se s' dij për perëndijt si t' a shpërblej.

### TELEGONI

Të marr më vehte? Ah, o perëndij,  
Ç'far' fjalësh po ndëgjojn' sot vesh't e mij!  
Më thuëj: 'ç' njeri m' pandeh ti muë, moj gruë?  
M' pandeh kusar a vjedhës deti muë  
Ti, a kujton qi jam Parid' i dytë  
Me sjellje t' liga dhe ojtni të ndytë,  
Qi shkoi ke Menelau atje në Spartë  
Dhe vodhi mbshehtazi Helen' e artë?  
Dhe un për t' vjedhë gra kam ardh' këtu?  
M' pandehke për të till njeri ti muë?  
Sikur dhe t' vidheshim na nga kjo anë,  
Ulisi atëbot' ç' kishte me thanë  
Për muë? — „Kusari erth e na shnderoi;  
Na vodhi grat dhe burrat i turpnoi“.  
Kundrejt atdheut ahëre do të vinte  
Ai dhe do t' a bante, bar t' mos binte.  
Si Trojën fare do t' a shkatarronte  
Dhe gjâ e gjall atje mâ s' do të rronte.  
Jo, gruë; të tilla fjal' t' mos bajm' na mâ,  
Por sjellmi armët, mir' në don me bâ;  
Se një njeri i ndershëm nuk kërkon  
Shpërblim mâ për at' gjâ qi e dhuron.  
A armët m' ep a po më len të shkoj,  
Se vehten me kto fjal' po e turpnoj.

### PENELOPEJA

M' qertovë shum' o djal, por po t' ndëgjoj  
Ti rri këtë nashti, se un po shkoj  
T' marr armët dhe t' i sjell t' i kesh' për herë;  
Me 'to t' largojsh' rrezikun, kûr të bjerë.



Ti prit dhe pak ktu, kij dhe pak durim,  
Se un po ikij dhe vinj me shpejtim.  
Do t' sjell një hark të bukur dhe një shigjetë  
Që një të till një t' jetër trim t' mos ketë.

## SCEN' E KATËRTË

### TELEGONI

Mâ n' funt prap vetëm mbeta; gruëja shkoi  
Dhe prej mërzis së madhe më shliroi.  
Një grüë që nuk e njoh a s' asht çudi  
Të dali dhe të më tregoi dashni?  
Ulis, i ndershëm at, a do t' a dijshtë  
Ojtnit e vendit tand se si jan' prishë?  
Një grüë e bukur që, asht e vërtetë.  
Por ah, ç' e don; kush din se kush do t' jetë.  
Nuk ban për moshën dhe për shkallën t' ime  
Dhe veset nuk më suëllën shumë pëlqime.  
Por mir' u bâ që erdhi; në këtë ças  
Munt t' vinj' t' më sjelli armët që të vras.  
At' plakun aq të nderit që më shnderoi  
Tyke më folë çka i erth ndër gojë.  
Pa shkak më foli, pa i bamun gjâ,  
Prandaj i marr shpërblimin tyk' e vrâ  
Të ligun që ke Hadi shpejt t' a çoj  
Edhë të paktat dit të ja shkurt'oj.  
Mir' them, kështu do t' banj; nashti fatbardhë  
E qëj dhe velen, se n' lthak' kam ardhë;  
Prandaj të vras at' plakun sâ mâ parë,  
Se munt pastaj që m' sjell ndonjë udhtar,  
I cili shkon n' qytet ke ati muë,  
Që kur t' më shohi shumë ka m' u gëzuë.  
Ja, tash po vjen dhe gruëja me shpejtim  
Me harkun e shigjetën. Oh, ç' gëzim!





## SCEN' E PESTË

### PENELOPEJA TELEGONI

#### PENELOPEJA

Ja prá; t'i pruna edhë armët, djal.  
Këtò t'i mbajsh gjithmon', se t'i kam falë,  
Qi kúr të shtijsh me 'to të më kujtojsh,  
Dhe kúr për dhé ti trima të lëshojsh.

#### TELEGONI

Të falemi, moj gruë, dhe qofsh me ndér,  
Të mirën t'a ndëgjofsha ty për herë.

#### PENELOPEJA

Ku don të shkojsh nashti? Ç'don t'banjsh? Më thuëj.

#### TELEGONI

Do t'fujem ktu në pyll dhe do gjuëj.

#### PENELOPEJA

Ç'far' kafshësh gjinden n' veñdin ku ke lé?  
Nga ç'an' po vjen dhe cilin ke atdhë?

#### TELEGONI

Moj gruë, ti po m'pyët shumë, më len të shkoj  
Nji her', se vinj pastaj e të kallxòj  
Për ç'far të duësh. T'çudiçme shumë jan' grat!  
Gjithmon' e tjerin bisedimin t'gjatë!  
Un tash po shkoj, se duë të gjuëj për drenj  
Këndëj nëpër kto brigje dhe shkëmbënj.

#### PENELOPEJA

Pastaj po deshe qi n' qytet të shkojsh,  
Eja përsri këlù qi t'më takojsh,  
Se un deri n' qytet t'përcjell me gas  
Dhe jam gati t'udhtoj me ty ç'do ças.



TELEGONI

Të falmi nderjes shumë për këtë kujdës,  
Por un s'udhtoj me ty sikur të vdes.  
Pa t'njohtun në vendin t'on nuk asht ojtni  
Që t'udhëtoj një grue me një djal të ri.

PENELOPEJA

Ah, fjalët t'uëja m'bijn' muë si shigjetë!

TELEGONI

Çudi! Por un kam folun në këtë jetë  
Me gjitha grát po kshu! — Eh, un po shkoj.

PENELOPEJA

Mir'ra; por kurrë të kesh ndonjë nevojë,  
Eja në këtë vend, se m'gjen' muë vetë.

TELEGONI

Mir'mir'; këtë do t'vinj për me të gjetë.

---

*Fund' i aktit të katërtë.*

---



# AKT' I PESTË

## SCEN' E PARË.

### PENELOPEJA

Mjaft ndenjta vetëm n' moshën t' ime t' é  
N' shtëpi pa búrr, porsì nji gruë e vé;  
Por tash, si búrr, i lik më tradhëtoi,  
Un për dashnor nji t' jetër do të kërkój,  
Se muë besnikërija m' ka shkuë kot;  
Prandaj t' gënjehem s' duë si deri sot,  
Ah, grat e vorfna! Kurdoher' gënjehen  
Ató me burrat, t' cilët u dëftëhen  
Sikúr i duër, edhë besnik' u rrijnë,  
Mirpo punojn' të zezën ku të gj'jnë.  
Edhë Ullis' i lik me Circeën donte  
Qi ditët mã të bukra t' i kalonte!  
Ai e don at' shtrigën më t' vërtetë,  
Se kët' dashni ja kam diktuë un vetë  
Atij. Oh, me ç' idhni më mbushet zemra!  
Nashti kuptoj qi s' u duruëka shemra.  
Por leni, leni t' gjitha; kúr fillova  
E nxeme për trahetín dhe e qertova,  
M' u dërth porsì i marr' dhe desh t' më p'si,  
Po t' mos na kish hym' biri ne ke mezi.  
Ah, gjersa t' jemi gjall edhë të rroj  
Atë s' e duë un mã, do t' a harròj.  
Por djali aq i bukur ku do t' jetë,  
Qi mori hark prej meje dhe shigjetë,  
Se nuk po duket mã këndëj përsri?  
Ah, un kam ran' të drejtën në dashni  
Ke aj djalosh, qi dhe prej vehtes s' ime  
Po turpënohem nga të till mendime.



Por ah, ç' të banj; nuk dij ç' të them, e duë;  
Që kur e pash' muë zemra m' u përvluë  
Për at' djalosh hyjnor, mirpo ai  
Më mbante muë qëpar' nji kryenaltsi  
Aq t' madhe sá s' dij qysh t' a them. Dashnija,  
Ah s' asht gjâ t' jetër veçse vet' marrija,  
Qi shkon edhë fatzezvet ngushullime  
U ep, mirpo fatbardhëvet mjerime.  
Ah qysh të vinj' edhë nji her' t' a shoh.  
Me sy, se kam dëshir' të madhe! Oh,  
Pse e kujtòj, si po m' lëvrin' muë gjaku!  
Ç' vështròj? Këtù po ardhka Telemaku!

## SCEN' E DYTË

TELEMAKU, PENELOPEJA

PENELOPEJA

Eh, bir! Pse vjen ashtù lyk' u menduë?  
A mos ti prej Ulisit je idhnuë?

TELEMAKU

Po, nan' e dashun, jam dënuë prej' tij  
Un tepër për nji gjâ pa randësi.  
Por s' dij ç' të them, moj nan', dhe perëndijt  
Po na gënjykan prá ne në kët' ditë,  
Se shërbëtori, qi erth prej qytetit  
Edhë orakullin. i solli mbretit,  
I tha qi prej të birit shum' të ruhet,  
Se po prej' tij nga bota do të shuhet.  
Por qysh munt t' bahet, nan', qi atin t' im  
T' a vras un? Pse? Për ç' pun' e për ç' qëllim?  
Prandaj po them: hyjnit po na gënjenjë,  
Sepse nuk bahen kto qi na dëftejnë.



PENELOPEJA

O bir, o Telemak, ti ç'far' po thuë?  
Qysh flet ti, bir, për perëndijt ashtu?  
Atá s'gënjenjn', por fjal' t'vërteta thonë,  
Se po t'vërteta na kan' than' gjithmonë.  
Sikur na thot' oraklli pash' dje mbramë  
Dhe un një andërr, qi muë shum' m'ka bamë  
T'idhnuëme dhe t'a thash' dhe ty, por ti  
Atë e quëjte krejt pa randësi.  
Prandaj arakllit lypset vumun mend,  
Se është i drejt' edhe i dhan' me vend.

TELEMAKU


Qysh lypset vumun mend orakllit, nanë?  
Un t' vras t' im at? Dhe ti kshtu don me thanë?

PENELOPEJA

Jo, bir, jo ti; yt at s' të ka veç ty  
Për bir; un kam një, por ai ka dy.  
Atij dhe Circa porsì un i puëll  
Një djal të dyt', qi për prapsi ja suëll  
Në bot', mbas mendjes s' imë, se ai  
Do t' jet' gjaksuër i t' et edhe jo ti.  
Prandaj, o bir, oraklli munt të jetë —  
Dhe është them pa dyshim un — i vërtetë.

TELEMAKU

Ah, nan', ty t'vele mendja mbë ca gjã  
Qi un besoj se s' munden kurr m' u bâ.  
Dhe Telegoni atin at e ka;  
Qysh mundet biri atin me e vrã?  
Pastaj prej shpellës s' Circes qysh munt t' vinjë  
Deri këtù dhe vendin t' onë t' a gjinjë?  
Por dhe sikur të thom' atdhën t' a gjinte;  
Përsë t' a vriste t' an' porsà të vinte?  
Dhe fjalët t' uëja, nan', s' jan' me arsyë;  
Un them kët' her' hyjnit na kan' gënjyë.



PENELOPEJA

Ndëgjò ti, bir, se ç' far' të thot' jot amë;  
Ajò mà tepër ka ndëgjuë e pamë  
Se ti; ndëgjoje prá se ç' far' të thotë  
Dhe fjalën mos ja merr ti për të kotë  
Më thuëj një her': ke pa ndonj' djal të ri  
Këndëj nëpër kto vande edhe ti?

TELEMAKU

Nji djal të huëj e pash', moj nan'; por pse?

PENELOPEJA

Por nuk e pyëte prej ç' far' vendi që?

TELEMAKU

E pyëta dhe më tha qi rron në Kretë.

PENELOPEJA

Muë s' më dëfteu; por prej andëj do t' jetë?  
Pse t' mos më thot' dhe muë si ty t' ka thanë,  
Por s' më dëfteu ku leu, në ç' vend e ç' anë.

TELEMAKU

Pse, nan', kujtòn ti qi dhe munt të jetë  
Ai djaloshi Telegoni vetë?

PENELOPEJA

Po, djalë; pse t' mos kujtòti? Në këtë botë  
Ç' far' s' munt të bahet? Njanit kúr i thotë  
Jam prej këndej ai dhe s' i kallxòn  
As fare t' jetrit; thuëj ti: ç' far' mendòn?  
A s' munt t' jet' Telegoni, qi të hasi  
T' yl at kërkòn këndej edhe t' a vراسي?

TELEMAKU

Nuk gjindet gjâ, moj nan', me të kujtuëme.  
Kto fjal' t' i lam' nashti na të mbaruëme.  
Të dy qëpar' për t' qen' u zun' me fjalë,  
Ulisi bashk' më at' të huëjin djal,



Po áti pati faj, qi për pak gjã  
Të shkretin djal deshi t' a lanj të vrã;  
Mâ n' funt ai mâ s' foli por pushoi;  
I bani udh' t' im áti edhe shkoi.

PENELOPEJA

Qysh? Paska ardhë puna gjer aty  
Sa qi të zihen? Ja; të thash' un ty  
Se pa dyshim ndonj' gjã ka me na dalë  
Ne me at' djalin, qi s' gjindet me nj' fjalë.

TELEMAKU

Nashti për muë, moj nan', lypset t' mendojsh,  
Si zemrës s' ime brengat t' ja largojsh,  
Sepse për bir s' më don mâ áti muë -  
Dhe t' ikij prej këndej më ka urdhnuë;  
Më tha të shkoj atje ku t' më pëlqejë  
Mâ mir', por veç t' largohem prej këndej.  
Nashti më thuëj prá ti ç' të banj, moj nanë;  
Muë m' duhet ty dhe vendin me e lanë!

PENELOPEJA

Qysh, bir, do t' ikish? Thuëj ku ke me shkuë?  
Por nanën vetëm do t' a lanjsh këtë?

TELEMAKU

Për vehten tande, nan', ti mos mendohu,  
Por për t' yt bir, fatkeqin, ti helmohu;  
Se ty të lanj n' pallat' n' mbretnuër të qetë  
Un, por nuk dij nga ç' an' të nisem vetë.

PENELOPEJA

Ah ti mësofsh, o búrr, si asht mâ zí,  
Qi djalin don t' largojsh nga syt e mij!

TELEMAKU

Mos ndiëll ti për Ullisin, nan', prapsi,  
Se át e kam atë un, búrr dhe ti.



Na duhet t'mira për atë të ndjellim  
E jo prapsina, se dobi nuk sjellim.

PENELOPEJA

Ah, bir, mbi gjith' këtë qi pò t'mundòn  
Shpirtligu, ti t'i dalsh për zot kërkòn?

TELEMAKU

Po nan', gjithmon' nji bir i del t'et zot,  
Dhe n'e mundofi' nji at të birin kot,

PENELOPEJA

Ah, bir, sá bukur flet, me sá arsyë!  
Por nana vetëm qysh do t'rrij' pa ty?

TELEMAKU

Ti ke t'im at, moj nan', qi të shoqnòn  
Dhe plagët zemrës s'ate ja pakòn.

PENELOPEJA

Ah jo; pa ty un s'duë as pak të rrij  
Këtù; dhe, un, o bir, me ty do t'vinj.  
Nuk duë t'ja shoh t'yt et as kurr syt mâ,  
Se për pak gjâ, dhe muë qe tyk' më vrâ.

TELEMAKU

S'ka gjâ, moj nan'; të kqijat s'ja shikòn  
Nji gruë e mir' të shoqt, por ja harròn,  
Se burrat mâ gjaknxehët i krijuën  
Hyjnit, por grat mâ t'buta n'bot' i pruën.

PENELOPEJA

Ah, un këtë pa ty s'rrij as nji ditë!

TELEMAKU

Rri nan', këtë të them në dijç hyjnit;  
Po m'deshe muë ti me t'vërtet' si bir,  
Mundesh të bânjsh nji t'tjetër gjâ mâ t'mirë.





PENELOPEJA

Ç'gjâ t'jetër mâ të mir' munt t'banj' për ty  
Nana, o bir, qi t'pa me zî me sy?

TELEMAKU

T'i thuëjsh t'im ati qi mos t'a besojë  
Orakullin dhe mos të më dëbojë  
Muë prej atdheut, se po t'i lutesh ti  
Un them qi zemrën do t'ja zbutsh atij.

PENELOPEJA

Qysh, bir, t'i lutem un atij gjaksori,  
Qi desh t'më vراسi kot dhe qi m'përdori  
Qëpar' si skllave.

TELEMAKU

Lutju ti për muë,  
Moj nan', po m'desh muë t'më kesh' këtù.  
Shikò; ti po t'i flaç atij përsri,  
Un them se do t'pendohet shum' ai  
Pastáj qi ligisht asht sjellë kundrejt teje  
Dhe muë qi t'rrij n'atdhé do t'm'api leje.  
Po t'mos i thuësh ti gjâ do t'më përzanjë  
Pa fjal'ai muë, dhe në ndonji skánjë  
Më duhet t'shkoj pastáj edhé të rrij  
Për jet'atjë lark njerzevet të mij.  
Prandaj, moj nan', për muë mos u kursè  
Ti, por shko lutju dhe pajtò me' te.

PENELOPEJA

Kúr qenka kshtu, o bir, un do t'ligjròj-  
Për ty prà me Ullisin, por s'besoj  
Qi t'më ndegjoi ai muë. Ti por shko  
Dhe për at' djal'n e huëj për rreth kërko  
Të mos e gjenjsh, se tash po m'vjen ndër mend  
Qi një shigjet' e një hark un në kët' vënd,  
E marra un i dhash', se m'i kërkoi  
T'i kish për mprojtje kúr t'ishte nevojë.



Por kush e din ç' i don ai ato,  
Prandaj dhe ti për t' a kërkue vrapo,  
Se munt t' na ngjaj' ndonji fatkeqësi  
Kënde'j nëpër kto pyje pa njeri.  
Shko pra dhe a të huëjin sjellma ktu,  
Ase t' yt at qi t' ligjëroj' me muë.

## SCEN' E TRETË

### PENELOPEJA

O sa e madhe asht dashnij' e fmijs!  
Qi t' mos largohet djali prej shtëpis,  
Me burrin zemërluk, qi nuk e duë  
T' a shok me sy t' ligjroj më duhet muë;  
Se ndryshe lark prej meje m' a përzë  
Muë djalin dhe në fatkeqsi më lë.  
Ah, burr, ah! Sot qi vjen nga vend' i huëj  
Dhe duhet plot gazmend ti njerzit t' uëj  
T' i përshëndeq, të zanjsh e t' më shnderojsh  
Dhe djalin lark prej syvet t' mâ largojsh?  
— Ah un e marra, prej dashnis së zjarrtë  
E verbët krejt në atë djal'n e artë  
Dëshronja t' vidhesh prej kënde'j dhe t' shkoje  
N' Atdhën e 'tij dhe bashk' me 'te të rroje;  
Qysh un e marra birin ktu t' a linje  
Dhe lark prej 'tij në dhë të huëj të rrije?  
Ç' gabim kam bâ un sot!... Sekur të jetë  
Aj djali Telegoni me t' vërtetë  
Edhe me armët e dhuruëme t' an  
Të vra' nëpër kto rrethe t' a ket' lanë!...  
Ah, sa në qridhet zemra kûr mendohem  
Për këtë vrasje t' shkret'! Oh, sa helmohem  
Sa do qi muë im shoq më duël pa besë  
Edhe me shpatën desh t' më sjelli kresë!  
O Jupiter, pse grät i ke krijuë  
Gjithmon' me zemër të tristuëshme kshtu? .



Vërtet Ulisi, Jupiter, do t'vritet  
Prej t'birrit si në templin t'uëj po flitet?  
Ah, búrr, ndonse as pak un nuk të duë,  
Por vdekj' e jote prap ka me m'helmuë!

### SCEN' E KATËRTË

TELEGONI, PENELOPEJA

TELEGONI

M'ndihmó, bâmirse, n'don të më ndihmojsh,  
Dhe prej rrezikut t'ardhshëm t'më shpëtojsh.  
Nashti t'udhtoj me ty un jam gati  
Dhe muë nevoja m'siell këtù ke ti.  
Un sà mâ par' dëshroj n'qytet t'arrinjë,  
Se ndryshë ktu e zeza do t'më gjinjë;  
Prandaj m'u shoqëno për udh', si m'thé,  
Edhe pallat'n e mbretit m'a dëftë.

PENELOPEJA

Ç'ke kshtu ti djal? Për mrapa kush të ndehet  
Qi po vrapon aq sà ty fryma t'mehet?  
Të ra njeri mbë, qaf' më thuëj prà ç'ké.

TELEGONI

Ah, gruë, t'a dijsh ti ç'kam!

PENELOPEJA

Më thuëj deh, pse  
Vështron kshtu rreth e rrotull kaq me frikë?  
A ndoshta ti ke bâ ndonj' pun' të ligë?

TELEGONI

E pe qëpar' një plak, qi kuvendoí  
Me muë?

PENELOPEJA

Aí qi nëpër sy më shkoí  
Kur vinja un me ty të flisnja?



TELEGONI

Po.

PENELOPEJA

Eh, ç' don të thuësh për 'te? Hâ prá m' kallxò.

TELEGONI

Mbasi qëpar' un kot, prej 'lij u shava,  
Prandaj dhe un me harkun tand e vrava.

PENELOPEJA

Ah!... Ah!... Qysh vrave ti, o djal gjaksuer,  
Ullisin, mbretin t'onë', me atò duër?!...

TELEGONI

Ullisin? Me t'vërtet' po m'thuë, moj gruë?

PENELOPEJA

Ullisin, po, ke vra ti.

TELEGONI

Upupu!...

Ah, un dorthati, ah, ç'far paskam bâ!  
O at i dashun, at, ty t'paskam vrâ!

PENELOPEJA

Yt at? Kush je ti? Telegoni? Thuëj.

TELEGONI

Un dora vet' jam, gruë; kaloi nji muëj  
Qi-po udhtëj gjlthnji un nëpër dët,  
Atdhën e atit t'im për me e gjetë;  
Por ah, 'mos kisha ardh' do t'ish mâ mirë,  
Se s'danja nji të till bolb të vështirë,  
Të vrisja atin, atin qi t'a shoh  
Nji her' me sy po e kërkoj kaq kohë!

PENELOPEJA

O búrr, o búrr, m'u ndavë krejt për jetë;  
T'yt shoqe dhe t'yt bir i lé të shkretël!

TELEGONI

Ti qysh i thret t'im ati? Búrr? Kush, jé  
Ti qi t'u dhims im at kaq shum'? M'dëftë!



PENELOPEJA

Penelopé më thëriste muë yt at.  
Kúr rronte, t' shoqes, qi i rrinte njat.

TELEGONI

Penelopeja ti? Vërtet më thuë?  
Por pse qëpar' nuk m'a dëfteve muë  
Kush qe ai, moj faqezez?

PENELOPEJA

Nuk doje,  
Mbassi m' duël i pabes', mâ t'a kujtoje,  
Përandaj s' të lhash' gjâ; po me gjith këte  
Muë zemra po m' vajton tash për ate.  
Por ti, kúr t' pyëta, pse nuk më, dëfteve  
Ç' i deshe armët, porse m' i rrëmbeve  
Nga duërët edhe shkove? Kush qe shkaku?

TELEMAKU

Ah nan! Nan'! Nan'!

TELEGONI

Kush asht?

PENELOPEJA

Ah, Telemaku!

SCEN' E PESTË

TELEMAKU, TELEGONI, PENELOPEJA

TELEMAKU

E paskan vra t' im at, e dashun nanë.  
Pa shpirt për dhé të ndemun e kan' lanë.

TELEGONI

Oh, vdekje, ç' pret ti mâ, eja më merr,  
Se jetën mâ s' e duël ajo m'u err.



TELEMAKU

Ah, qysh? Ti ktu? Ti vrasës i t' im ati  
Je pa dyshim.

TELEGONI

Ah, un jam; un dorthati!

TELEMAKU

Ti t'vraç t' im at e mbretin t' on', barbár?

PENELOPEJA

Ndalò, o Telemak, edhé mâ parë  
M'ndëgjò dhe mue, se kte e ke ti vllá;  
Ky Telegoni asht edhé ka vrà,  
T'yt-at e t'an'pa n'jofte prej nevojë;  
Prandàj nashti t'yt vllá, bir, përqafoje.

TELEMAKU

O Telegon, ç'asht gjith'ky tmerr, o vllá,  
Të vraç ti atin qi s'e pate pà  
As kurr me syl!

TELEGONI

O Telemak, shpërbleje  
Ti gjakun e Ulisit tash prej meje;  
Se un nuk duë të rroj në botën mâ;  
Prandàj me shpatën shpoje tash t'yt vlla.

PENELOPEJA

Psho, djal, mos fol ashtù, sepse që thanë  
Nga perëndijt t'yt at të vdek'm'e lanë.

TELEMAKU

Por na kallxó nashti ti na, o vlla?  
Për këtë ngjarje t'idhët qysh u bâ?

TELEGONI

Ah, vlla, kam dit qi lark prej Circes rroj,  
Prej nanës s'ime, dhe në dé! udhtoj



Për t'gjet' lthakën, se dëshir' pa masë  
Paç un t'im at, të dashmën, për t'a hasë.  
Por ah; me'të porsà sot u takova,  
Sikur e din dhe ti, un u shnderova  
Prej'tij aq shum'sa s'ka si bahet mâ;  
Por vetëm dashjen tande për t'a bâ  
Un ula k-yët e shkova fjesht idhni.  
Mirpo më gjeti vetëm muë përsri  
Këtù ai dhe p-ap me më shnderuë  
Filloi, edhë më zi un kam shpëtue  
Prej'tij. Pastaj këtù t'yt am' kam gjetë,  
Të cilës për një hark e një shigjetë  
Ju lutsh tyke i thanë qi i duë  
Vehten të mproj. Dhe kjo m'i fali muë  
Atò mâ n'funt, se fjalvet m'i besoi  
Dhe se mbshehtsinën t'ime s'e kuptoi.  
Rrëmbeva armët prà un dhe kërkova  
Për atin; si e gjeta mir'shënova  
Me shqjetën, t'cilës i paç vuë në kryë  
Një halë peshku, qi me helm qe lyë  
Edhë qi Cincia muë m'a kish dhuruë,  
Me'të kundreit anm'qvet për t'u mpruë.  
Kësh'ù e vrava atin, vlla ... oh vdekje,  
Eja më merr, se jeta m'asht muë hjekje!

### TELEMAKU

Ah, qoft' mallkuë ai qi than' gënjeshitër!

### PENELOPEJA

Kshtu qenka than' për na, o bir e thjeshtër;  
Ju t'shinni atin dhe un burrin t'im  
Në vdekje kaq të tmerrshme pa rrëfim.  
Ecni nashti të shkojm' edhë t'a ngremë  
Prej vendit ku ai pa shpirt' asht ndemë.

